

30 Ditët 2011

Nga data 1 deri 30 gusht

e lutjes për botën Myslimane



Besim, shpresë dhe dashuri që prodhojnë jetë të përjetshme

Botimi i 20

Hyrje

Kjo thirrje për lutje për Myslimanët e ka zanafillën nga një takim i disa liderave të Krishterë në Lindjen e Mesme në 1992. Disa besimtarë të përfshirë në një lëvizje ndërkombëtare e ndjenë fort dëshirën e Perëndisë për t'iu bërë thirrje sa më shumë të krishterëve që të ishte e mundur të luteshin për botën Myslimane. Kështu një lëvizje lutjeje u planifikua me qëllim që të konçidonte me muajin Islamik të Ramazanit i cili ndjek një kalendar hënor (në vitin 2011 i takon të jetë nga data 1-30 Gusht). Qëllimi ishte që “30 Ditët” të ishte gjatë muajit të Ramazanit për të paktën dy arsye: (1) si një mënyrë që të krishterët të identifikohen me Myslimanët gjatë një periudhe të caktuar të vitit dhe (2) për të kërkuar ndërhyrjen sovranë të Perëndisë në jetët e Myslimanëve gjatë një periudhe të vitit kur ata janë veçanërisht fetarë. Ju lutem keni parasysh që të lutemi gjatë muajit të Ramazanit nuk do të thotë që ne konformohemi me praktikat Myslimane të agjërimt dhe lutjes. Si besimtarë në Jezusin ne nuk jemi dakord me idetë, teologjinë dhe praktikat Islamike në disa fusha. Megjithatë lëvizja “30 Ditët” thekson dashurinë e Perëndisë për Myslimanët. Ne inkurajojmë të gjithë besimtarët në Mesian të kultivojnë një frymë përlulje, dashurie, respekti dhe shërbimi ndaj Myslimanëve.

Qëllimi i këtij udhëzuesi lutjeje, është të frymëzojë dhe drejtojë çdo lexues ndërsa ai ose ajo ndërmjetëson për botën Myslimane. Megjithatë ky udhëzues nuk jep të gjithë informacionin e plotë. Ne ju inkurajojmë të kërkoni informacion të mëtejshëm me qëllim që të njihni më shumë botën Islame dhe lëvizjen e Perëndisë midis Myslimanëve. Përsëri këtë vit në këtë libërth kemi përfshirë disa dëshmi me qëllim që të inkurajojmë besimin tuaj ndërsa ju luteni. Perëndia i do Myslimanët. Ai dëshiron që ata të mund ta njohin Atë.


Botuesit

Përpyekja jonë njëzetvjeçare e lutjes për botën Myslimane



Nga të dbënat rezulton që tre deri në katër milion Myslimanë janë bërë besimtarë në Mesian këto 20-30 vitet e fundit.

Më shumë Myslimanë janë kthyer në Mesian në vitet e fundit sesa gjatë 1400 viteve që nga koba e Mubamedit.



Sipër: Kopertina e broshurës së parë “30 Ditët e Lutjes” e cila u prodhua për versionin e vitit 1993. Më poshtë versione më të fundit.



Botimi 20 i “30 Ditët”

Dy dekada lutje me besim, shpresë dhe dashuri për botën Myslimane.

Cfarë ka ndryshuar gjatë 20 Ramazanëve?

Kanë ndodhur shumë gjëra gjatë këtyre 20 viteve të fundit. Perëndia po punon duke përdorur mënyra të ndryshme për ta bërë veten të njohur midis Myslimanëve. “30 Ditët” ka luajtur një rol të rëndësishëm për ndërgjegjësimin e besimtarëve dhe promovimin e lutjes për Myslimanët në mbarë botën. Megjithatë “30 Ditët” është vetëm një aspekt e asaj që po bën Perëndia! Shumë gjëra kanë ndodhur.

Pozitivisht:

- Mesatarisht tre deri në katër milion Myslimanë janë bërë besimtarë në Mesian këto 20-30 vitet e fundit. Ky është numri më i madh i arritur ndonjëherë krahasuar me 1400 vitet e fundit. (Muhamedi ka jetuar në vitet 570-632 pas Krishtit)
- Numri i shërbesave që përfshijnë internetin, radion, televizionin satelitor dhe shërbesa të tjera nëpërmjet medias për Myslimanët janë në lulëzim e sipër.
- Sasia e literaturës, CD-ve, DVD-ve, Biblave dhe materialeve që mund të shkarkohen nga interneti të disponueshme për Myslimanët është rritur në mënyrë domethënëse.
- Numri i misionarëve aktualë që punojnë në botën Myslimane është rritur ndjeshëm.

- Mijëra ish-Myslimanë po shpallin Mesian te njerëzit e tyre.
- Gjithashtu ka më shumë përpjekje lutjeje për botën Myslimane se kurrë ndonjëherë.
- Ne kemi informacion mbi botën Myslimane më shumë se kurrë ndonjëherë. (mbi demografinë, mbi ngjashmëritë kulturore, historinë e tyre dhe progresin e Ungjillin te ta.
- Përpjekjet për të ngritur komunitete besimtarësh në të gjitha grupet etnike po bëhen realitet.
- Myslimanët janë ekspozuar me kultura dhe besime të tjera fetare më shumë në kohët e sotme gjatë këtyre 1400 viteve të fundit.

Negativisht:

- Terroristët Myslimanë janë vendosur në shumë vende të botës. Sulmet e tyre më të famshme të 11 Shtatorit 2001 tronditën botën.
- Këto sulme dhe të tjera nxitën dy lufta shumë të vështira në Afganistan dhe Irak po ashtu edhe shumë ndërhyrje ushtarake dhe policore në gjithë botën me efekte pozitive dhe negative. Myslimanët nuk kanë qënë gjithnjë dakord me “luftën kundra terrorizmit”. Disa situata janë shumë komplekse.



Çdo vit 240,000 deri në 400,000 broshura lutje shpërndahen në gjithë botën në gjuhë të ndryshme.

*Shih faqen tonë kryesore të internetit:
www.30-Days.net*

Gjithashtu në:  

- Shumë televizione Islamike, faqe interneti, radio dhe media të tjera janë në dispozicion si kurrë më parë.
- Numri i Myslimanëve dhe i xhamive në shumicën e vendeve perëndimore është rritur ndjeshëm.
- Prezenca Islamike në Evropë dhe në vendet Perëndimore në përgjithësi është bërë një kërcënim për shumë kombe. Shoqëritë e hapura ateiste në vendet Perëndimore nuk dinë si të merren me prezencën Islamike në vendin e tyre. Frika e terrorizmit, frika e të panjohurës, po ashtu edhe paragjykimet dhe fanatizmi ndaj Myslimanëve janë rritur në shumicën e vendeve Perëndimore.

Disa njerëz pyesin: “Pse të lutemi për Myslimanët?”




Myslimanët zakonisht nuk e kuptojnë:

- ... që ata duhet ti binden, Jezusit, Mesias.
- ... që Jezusi ka aftësinë të falë mëkatet.
- ... që Jezusi e ka mundur vdekjen nëpërmjet ringjalljes së Tij.
- ... që Jezusi ka fuqi mbi frymërat e këqija.

Ti je i denjë . . . , sepse ti u therre, dhe me gjakun tënd na bleve te Perëndia nga çdo fis, gjuhë, popull dhe komb. (Zbulesa 5:9)

Kjo është arsyeja pse lutemi ne.

- *Myslimanët e mendojnë Jezusin si një profet të madh i cili predikoi një formë më të hershme të Islamit. Ata besojnë që Jezusi është Mesia i Perëndisë, sipas teksteve të Kuranit, por normalisht nuk e dinë që kjo do të thotë që Jezusi është Mbreti dhe Shpëtimtari i vajosur i Perëndisë për gjithë njerëzimin.*
- *Myslimanët zakonisht besojnë që ata mund të fitojnë pranimin nga Perëndia nëpërmjet aktiviteteve fetare. (lutje, agjërim, dhënie parash).*
- *Myslimanët nuk mendojnë që ata mund të njohin Perëndinë. Ata mendojnë që ata vetëm mund të mësojnë për Të.*



... për gëzimin që ishte përpara tij, duroi kryqin duke e përçmuar fyerjen dhe u ul në të djathtën e fronit të Perëndisë. (Hebrenjve 12:2).



Përgjigje:

... sepse Ai derdhi gjakun e Tij.

Autoriteti

- *Ne kemi nevojë të dimë se kush jemi në Perëndinë.*
- *Ne jemi në mbretërinë qiellore.*
- *Jezusi është Mbreti plot drejtësi i botës.*
- *Ne lutemi në emër të Zotit.*
- *Ne kërkojmë laudinë e Tij.*
- *Ne lutemi që vullneti i Tij të bëhet.*

Dijeni që ...

Ne si besimtarë kemi një privilegj të mrekullueshëm. Perëndia na fton ne të bëhemi pjesë e shpalljes së Lajmit të Mirë në gjithë botën. Ai madje na jep autoritetin dhe fuqinë për ta bërë këtë punë. Ju lutem jini të vetëdijshëm që egzistojnë forca shpirtërore të cilat ne nuk i shohim që e kundërshtojnë planin e Perëndisë për të sjellë Lajmin e Mirë të Myslimanët. Ndërsa e përdorni këtë broshurë ju gjithashtu duhet të luteni për mbrojtjen tuaj. Ne nuk duhet të trembemi nga bota e padukshme, por të lutemi me besim e siguri të vetëdijshme për rreziqet dhe duke u gëzuar për ndërhyrjen e Perëndisë në jetët e gjithë njerëzve. **Meditoni mbi këto shkrime: Efesianëve 6:10-20, Jakobit 4:7,1 Pjetrit 5:8-9, 2 Mbretërvë 6:16-17.**



*Lutu me besim në Perëndinë,
Atë që mban premtimet.*

*Lutu me shpresë
për një të ardhme më të mirë për Myslimanët.*

*Lutu me dashurinë
që e bëri Jezusin të duronte kryqin.*

Si duhet t'a përdorim këtë broshurë?

Gjatë javëve të ardhshme, ju mund të luteni dhe gajeroni në disa lloj mënyrash. Në disa ditë pesë minuta mund të jetë gjithçka që Perëndia mund të kërkojë nga disa prej jush, në këtë përpjekje lutjeje. Megjithatë ndonjëherë pjesëmarrësit do të udhëzohen të lutën për periudha mjaft më të gjata. Mund ta përdorni këtë broshurë për t'u lutur gjatë kohës tuaj të lutjes, ose bashkohuni me të tjerët për t'u lutur së bashku. Ne do t'ju inkurajojmë të gjenit mënyra krijuese për të përfshirë sa më shumë njerëz që të jetë e mundur në këtë fokus lutjeje. Jezusi ka bërë premtime të veçanta për bekime për të Krishterët që lutën dhe bien dakord së bashku (Mateu 18:20).

Ju lutem përdorni Biblën sa më shumë që të mundeni ndërsa luteni. Ne kemi përfshirë referenca të ndryshme nga Bibla në gjithë broshurën. Do të ishte mirë të meditoni mbi këto shkrime dhe të thoshit me zë të lartë ndërsa luteni. Shpallini ato përpara Perëndisë; kërkojini Atij t'ju frymëzojë. Kjo gjë do të ndërtojë besimin tuaj dhe Perëndia mund t'ju japë

pikëpamje të reja për lutje mbështetur në Fjalën e Tij.

Ju mund të organizoni disa takime një ose dy herë në javë gjatë kësaj periudhe 30 ditore me kishën tuaj, grupin e të rinjve, qelizën tuaj apo grupin e fëmijëve. Pto të tjerë të bashkohën me ty në një vakt të veçantë ushqimi duke përdorur temën e lutjes për atë ditë. Mund të zbuloni gjithçka që mundeni për atë kulturë të veçantë, përfshirë ushqimin dhe veshjen, muzikën etj.

Do të ishte mirë nëse një person zgjidhet si drejtues/ndihmësi i grupit për këtë kohë lutjeje. Ky person mund të drejtojë dhe lidhë grupin. Do të ishte më mirë nëse grupi fokuson lutjet e tij në një fushë të caktuar në një periudhë të caktuar, sesa të ndryshonte fokusin e tij vazhdimisht. Çdo person duhet të presë para se të kalojë në një temë tjetër, duke i dhënë mundësi secilit të lutet për secilën temë (1 Korintasve 14:40). Perëndia është krijues, dhe na ka bërë ne në imazhin e Tij, prandaj mund të presim ide dhe lutje krijuese ndërsa e kërkojmë Atë. Fryma e Shenjtë do t'ju drejtojë në lutje (Rom.8:26).



“Do t’i coj në malin Tim të shenjtë dhe do t’i mbush me gëzim në shtëpinë time të lutjes ; olokaustet e tyre dhe flijimet e tyre do të përleqehen mbi altarin tim, sepse shtëpia ime do të qubet shtëpi lutjeje për të gjithë popujt.”

(Isaia 56:7)



Realitetet Shpirtërore (1)

Jezusi i ka thirrur ndjekësit e tij të jenë dritë në një botë të erësirës. Po ashtu si gjithë njerëzit e tjerë në gjithë botën Myslimanët duhet të ndeshen me të keqen dhe me realitete shpirtërore të padukshme të cilat manifestohen në mënyra të ndryshme ne fe dhe në kulturë. Këto realitete shpirtërore negative po influencojnë dhe po dominojnë qytetërimin Islamik po ashtu edhe qytetërimin Perëndimor dhe Lindor në përgjithësi (1Gjonit 5:19). Këto forca shumë shpesh mund të mposhten nga njerëz që bëjnë gjërat e kundërta (apo për ta thënë më mirë, me një frymë “të ndryshme”). Jezusi na ka treguar mënyrën e tij sesi t’ a bëjmë këtë nëpërmjet kryqit. Në dobësinë e Tij, Ai në të vërtetë demostroi forcë. Aty në kryq krenaria e Perandorisë dhe feja u përpoqën t’i bënin keq Atij, por rezultati përfundimtar ishte që Jezusi në fakt manifestoi mirësinë e tij finale për të gjithë njerëzit. Perëndia na ka dhënë një urdhërim: “mos u mund nga e keqja po munde të keqen me të mirën” (Romakëve 12:21).

Ndërsa lutemi për Myslimanët dhe ndërsa jetojmë me ta ne duhet të shqyrtojmë jetën e Perëndisë. Armiqtë tanë frymorë na shtynjë ne si besimtarë ti kemi frikë e të jemi dyshues ndaj Myslimanëve. Nëse ne e lejojmë veten të motivohemi nga frika, mbrojtja e vetes dhe dyshimi në vend të besimit, shpresës dhe dashurisë, ne nuk do të jemi në gjendje t’ua sjellim Ungjillin Myslimanëve.

*“Perëndia është dashuri”
shkruar në arabisht*

Ide për lutje:

Sot edhe nesër ne do i’u kërkonim të adhuroni Perëndinë. Afrojuni Perëndisë. Rezistojini djallit dhe ai do të largohet nga ne. Më pas lutuni për temat e mëposhtme për veten tuaj dhe për Myslimanët në qytetin, në zonën dhe në vendin tuaj:

► **Ku ka krenari---përlulje:**

Lutuni: “Zot, shkul çdo rrënjë krenarie brenda meje që ka lidhje me qëndrimet e mia ndaj Myslimanëve. Çliriji Myslimanët në zonën ku unë banoj nga krenaria fetare. Na sill ne të gjithëve në përlulje para Teje.” (Fjalët e Urta 8:13, 16:18, 29:23).

► **Ku ka fetarizëm---marrëdhënie:**

Lutuni: “Zot, më ndihmo që të mos bëhem fetar por në të vërtetë të jetoj dhe të ec me ty”. Ndhimo këdo Mysliman në zonën time që të të njohë Ty dhe jo thjesht të kryjë disa veprimtari fetare.” (Gjoni 17:3)

► **Ku ka legalizëm---liri:**

Lutuni: “Zot, më ndihmo të eci në lirinë e Frymës Tënde. Më ndihmo që të jem dikush që sjell liri të vërtetë të Frymës tek Myslimanët.” (Mateu 7:3-5)

► **Ku ka dyshim---besim:**

Lutuni: “Le të jemi ne si besimtarë njerëz që krijojmë besim me qëllim që Myslimanët të mund të besojnë dhe të kthehen te Mesia.” (Veprat 16:14)



Dëshmi

Algjeri, kryeqyteti
i Algjerisë

Nacima, familja e të cilës vjen nga një prejardhje Algeriane Kabyle u lind dhe u rrit në Francë. Nëna e saj kishte bindje konservative dhe popullore islamike, por i ati ishte më i hapur. Nacima kishte mësuar nga e ëma që Perëndia ekzistonte por edhe pse e dinte këtë ajo jetonte me frikën e vdekjes.

Pavarësisht aspekteve shumë pozitive të jetës që ajo bënte në familjen e saj, shkollës dhe sporteve, Nacima zbuloi që kishte boshllëk në shpirtin e saj. Kur ishte 18 vjeç, ndërsa vazhdonte universitetin ajo dhe shoqet e saj filluan të eksplororonin pyetje të tilla si: “Pse ekzistoj në këtë botë? A ka kuptim jeta ime? Çfarë ndodh pas vdekjes? Megjithatë ajo nuk dëgjoi asnjë t'i fliste për Jezusin si më shumë sesa një figurë historike. Edhe pasi kishte bërë dy vjet studime universitare ishte e qartë për Nacimën

që Perëndia ekzistonte por ajo akoma nuk kishte besimin e vërtetë. Në verën e ardhshme Nacima dëgjoi për Jezusin në një mënyrë të re. Kur ajo shkoi të rrinte me familjen e saj për dy javë, motra e saj e madhe i tregoi sesi Jezusi kishte transformuar jetën e saj. Nacima pa se dashuria e Perëndisë ishte manifestuar nëpërmjet Mesias, Jezusit. Nga fundi i Korrikut Nacima kuptoi thellësinë e mëkatit të saj personal. Me ndihmën e motrës së saj dhe të Frymës së Shenjtë ajo zbuloi dritën e vërtetë. Nacima besoi që Jezusi vdiq dhe u ngrit prej së vdekurish për të dhe besimi zuri rrënjë në zemrën e saj. Vdekja ishte mposhtur nga ringjallja e Jezusit dhe frika e Nacimës nga vdekja u mposht. Ajo e gjeti arsyen për të jetuar; arsyeja ishte t'i shërbente Atij që dha jetën për të.

Realitete Shpirtërore (2)

Vazhdoni të luteni në të njëjtat linja si ditën e djeshme. Është e rëndësishme të vendoset një themel i mirë për 28 ditët e mbetura.

Ide si të lutemi:

Mos harroni identitetin tuaj shpirtëror. Ne jemi fëmijë të Perëndisë me anë të gjakut të Mesias. Ne i shërbejmë Atij që ka gjithë autoritetin në qiell dhe në tokë. Shpalli këto të vërteta në adhurim. Lutu për temat e mëposhtme për vete dhe për Myslimanët që mund të jenë në qytetin, zonën, apo vendin tuaj.

► **Ku ka hidhërim---zemërbutësi:**

Lutuni: “Zot, largo gjithë hidhësinë nga qëndrimet e mia ndaj Myslimanëve. Ndihej Myslimanët të merren me çdo hidhësi në zemrat e tyre.” (Efesianëve 4:31, Hebrejve 12:15)

► **Ku ka frikë---dashuri:**

Lutuni: “Zot, na ndihmo të mposhtim frikën. Dashuria jote e nxjerr jashtë frikën. Më ndihmo që të jetoj sipas kësaj mënyre.” Myslimanët shpesh jetojnë me frikën nga të tjerët, me frikë nga frymërat e këqija dhe me frikë nga vdekja. (1 Gjonit 4:18, 2 Timoteut 1:7)

► **Ku ka epsh---pastërti:**

Ne dhe të gjithë Myslimanët kemi nevojë të largohemi nga korrupsioni i cili ekziston në botë nëpërmjet epshit. (2 Pjetrit 1:4; 1 Gjonit 2:16). Myslimanët nuk janë të lirë nga pornografia dhe lakmia. Duke e ditur që edhe ne tundohemi gjithashtu, lutuni për veten dhe për ta.

► **Ku ka dhunë---paqe:**

Shumë Muslimanëve në të vërtetë nuk i'u pëlqen dhuna që shohin në disa aspekte të Islamit. Shumë prej tyre e kundërshtojnë dhe refuzojnë të jetojnë në atë mënyrë. Lutuni për ta që të gjejnë rrugën e paqes. Perëndia na ndihmoftë ne si besimtarë që të mos jemi burim dhune dhe qëndrimesh urrejtjeje ndaj Muslimanëve. (Mateu 5:9, Luka 1:78 dhe 10:5-6, Romakëve 3:17)



Në të majtë: Kullat Abraj Al Bait në ndërtim e sipër në Mekë në vitin 2010. Kompleksi është planifikuar të përfundohet në vitin 2011.

DATAT PËR RAMAZANIN

Datat për Ramazanin janë përcaktuar sipas kalendarit Islamik hënor prej 354 ditësh. Duke filluar 11 ditë më herët çdo vit, duhen 33 vjet që Ramazani të bjerë në të gjitha stinët e vitit. Në vitin 2011 Ramazani do të jetë nga 1-30 Gusht. Kjo varion pak nga njëri shtet në tjetrin. Periudha e agjërimit normalisht fillon dhe përfundon me daljen e hënës së re. Për më shumë informacion konsultohuni me faqen islamike të internetit: www.moonsighting.com. Për shkak të faktit që viti Islamik ka gjithnjë ndryshime, broshura e vitit 2011 i bie të jetë botimi ynë i njëzetë. Kanë kaluar 20 vite

hënore Islamike që kur kemi nxjerrë botimin e parë “30 Ditët” në Mars të vitit 1993. Ky është viti 1432 i kalendarit Islamik hënor. (Shënim: Hëna nuk është objekt adhurimi në fenë Islamike.)



Klasa Punëtore e Mekës

Duke u lutur për popullin në qytetin e shenjtë të Arabisë Saudite

Meka është qendra shpirtërore e botës Islame. Zonat fetare të cilat frekuentohen nga pelegrinët i bëjnë mësimet dhe aktivitetet e Muhamedit më reale. Çdo ditë miliona Myslimanë kthehen nga Meka pesë herë në ditë gjatë lutjeve të tyre ditore. Mijëra njerëz punojnë në Mekë, ku merren me menaxhimin, mirëmbajtjen dhe pastrimin e hoteleve, punojnë në restorante, transportojnë ushqime, shesin ushqime, punojnë si udhërefyes, shesin bizhuteri floriri dhe suvenire. Shumë më tepër punojnë në industrinë e transportit si shoferë autobusash apo taksish. Industria bankare është gjithashtu e rëndësishme sepse miliona pelegrinë që vijnë në zonë kanë nevojë për para kesh. Të gjitha llojet e veprimtarive të shëndetit publik (mjekë, infermierë, inspektorë, personel të ambulancave dhe punëtorë që mbledhin plehrat) janë prezentë dhe përipiqen të sigurojnë shëndet të mirë dhe siguri për miliona vizitorë. Koordinatori i përgjithshëm i “30 Ditët” madje ka studiuar në të njëjtin universitet me disa nga burrat që janë bërë administratorë të shëndetit publik për peligrinazhin. Në vitet e fundit industria e ndërtimit ka transformuar zonën rreth Xhamisë së Madhe dhe Qabesë me qëllimin që të zgjerohet vendi për më shumë pelegrinë. Njerëzit që vijnë te Krishti në Mekë janë të rrallë, megjithatë ka disa që e kanë njohur Zotin në këtë qytet prej 1.7 milion njerëzish.

Idë për lutje:

- ▶ *Përdorni Zbulesën 4:11 dhe 5:4-14 për të deklaruar që Jezusi është i denjë të adhurohet nga populli i Mekës (nga punëtori më i thjeshtë deri te princesha e familjes mbretërore Saudite).*
- ▶ *Lutuni që ekspozimi me marrëdhëniet, ëndrrat, vizionet, internetin, shtypin dhe median do të shumëfishojë Ungjillin të gjithë punonjësit që u përmendën më lart (përmendi ata me emra).*
- ▶ *Lutuni që besimtarët e rinj do të integrohen mirë në komunitetet e besimtarëve.*

Fiset e Arabisë Saudite

Në Arabinë Saudite ka rreth 150 fise. Këtë vit Ne ju kërkohet besimtarëve të lutën specifike për fisin Utaybah (që gjithashtu shkruhet edhe Utaiba, Otaibah ose Otaiba). Fisi Utaybah tradicionalisht ka jetuar në veri të autostradës Riad-Mekë në shkretëtirën midis kryeqytetit Saudit, Riadit dhe Jedës në Detin e Kuq. Residencat e kryetarit të fisit është Afifi, një qytet i vogël prej 90,000 banorësh, rreth 600 kilometra në Perëndim të Riadit. Shumë Utaybah gjenden në Riad, Jeda dhe deri në Kuvajt. Fisi Utaybah historikisht ka patur një rol në ushtrinë Saudite që në ditët e hershme të mbretërimit të Abdul Aziz Al Saudit, themeluesi i dinastisë aktuale në pushtet. Fisi Utaybah përbëhet nga tre degë kryesore: Barga (dega më e madhe), Rog, dhe Banu Saad (Bijti e Saadit). Secila nga këto degë ndahet në shumë klane dhe familje.

Klanet dhe familjet e fisit Rog janë :

Klani Talhah përfshin familjet e mëposhtme: Alasa'adah, Alhufah, Alsumarrah, Alhanateesh, Algharbiah, Alkarashemah, Alhamameed, Alhezman, Almagaibah, Thoi Zarrag, Alghadhabeen dhe Alawazem.

Klani Mezhem përfshin familjet e mëposhtme:

Thoi Thubait, Alothyian, Alghubaiat, Almarashedah, Aljetha'an, Alseaheen, Thoi A'ali dhe Thoi A'tyah..

Klani Bano Saad përfshin familjet e mëposhtme:

Albatnain, Allessah, Alsurairat dhe të tjera.

Ide për lutje:

► *Adhuroni Perëndinë, Zotin e shkretëtirës. Lexoni Psalmin Mesianik 72:1-20. Shpallni sovranitetin e Perëndisë mbi shkretëtirën dhe mbi fisin Utaybah. Lutuni për zbulimin e Mesias midis tyre dhe për shpëtimin e tyre. Shih vargun 9: "Banorët e shkretëtirës do të përkulen para tij dhe armiqët e tij do të lëpijnë pluhurin. Lutuni për të paktën një nga pesë nënklanet e përmendjura më lart. Ju jeni nga njerëzit e parë që do i përmendni specifikeisht këto nënklane në lutje.*

(Shih faqen e internetit www.lovesaudis.com për informacione shtesë rreth Arabisë Saudite).

Sheshi Tahir në qendër të Cairos i cili ishte skena e kryengritjeve të 2011 që rrëzuan Hosni Mubarakun nga pushteti.



Kryengritja e Libisë

Revolucioni Egjiptian

Protestat e Bahrenit

Tunizia fiton lirinë

Përleshjet në Jemen

Pakënaqësi në Algjeri

Xhamia ku është varosur trupi i Muhamedit në Medinë, në Arabinë Saudite.



Të Kërkosh Lirinë !

Fokus: Lutja e së premtes

E shkruar në fillim të Marsit 2011

Në draftin e parë të broshurës “30 Ditët” në Dhjetor të vitit 2010 u përfshi dhe një artikull që lidhej me lutje për zgjedhjet e Egjiptit i cili ishte nën pushtetin e Mubarakut (zgjedhjet që ishin planifikuar të bëheshin në Shtator të 2011). Më pas erdhi revolucioni Tunizian i cili shumë shpejt u ndoq nga rrëzimi i Presidentit Hosni Mubarak në Egjipt. Në fillim të Marsit 2011 ne po përgatitnim disa versione të “30 Ditët” për printim. Revolta në Libi kundra Muamar Gedaft është në zhvillim e sipër por Diktatori është akoma shumë i vendosur dhe i rezikshëm. Në vende të ndryshme akoma po organizohen demonstrata masive. Bota Myslimane po kalon një përshtjellim të madh. Mbreti i vajosur i Malit Zion mbretëron (shiko Psalmi 2). Kush e di sesi Ai do të veprojë në të ardhmen?

Dëshira për liri të cilën Tunizianët, Egjiptianët, Libianët, populli i Jemenit dhe të tjerë e kanë shprehur në muajt e fundit është e rrënjësorë thellë në zemrat njerëzore. Në një pikpamje finale kjo dëshirë mund të përbushet vetëm nga Mesia. Ai është caktuar të mbretërojë mbi popujt e botës me drejtësi dhe drejtësi (shiko Psalmi 72 dhe Danieli 7:13-14). Ai do të ulët si një gjykatës dhe do të korrigjojë të gjitha gabimet (Veprat 17:31). Bukuria e mbretërimit të tij në qiejt e rinj dhe në tokën e re s’do të ketë të krahasuar (2 Pjetrit 3:13, Zbulesa 21:1-4).

Ide për lutje:

- ▶ *Adhuroni Mesianin i cili na ka çliruar nga fajet dhe nga fuqia e mëkatit. Një ditë Ai do të na çlirojë edhe nga prezenca e mëkatit. Mesia na çliron në fuqinë e vdekjes, ne do të ngrihemi sërish me trupa të cilat nuk do të vdesin më kurrë. Mesia është kundër çdo lloji korrupsioni, shtypjeje dhe padrejtësie. Ai e ka mposhtur të ligun dhe qëndrimet, vlerat dhe rrugët e kësaj bote.*
- ▶ *Lutuni për Lindjen e Mesme dhe Afrikën Veriore për ngjarjet e fundit atje.*
- ▶ *Myslimanët e njohin Jezusin si Mesianin pa kuptuar se çdo të thotë kjo apo pa kuptuar që ai jep liri të vërtetë nëpërmjet vdekjes dhe ringjalljes së tij. Lutuni që shumë do ta takojnë Mesianin.*
- ▶ *Lutuni për mbrojtjen, inkurajimin dhe fuqizimin e besimtarëve në këtë kohë krizash.*

Kolai i Pakistanit

Jini ndër të parët të luteni për këtë grup

Pakistanian verior, i cili kufizohet me Kinën në veri, Afganistanin në veriperëndim, dhe Indinë në lindje, ka disa nga vendet më mahnitëse në botë për t’u vizituar. Pikërisht, të vendosur midis pesë majave të maleve më të larta në botë, gjenden fiset veriore të Pakistanit. Fisi Kolai është një prej tyre, dhe ka një popullsi që shkon deri në 410 000 banorë. (vitin e kaluar u lutëm për popullin e fisit Kho). Shumica e njerëzve në këtë rajon punojnë si fermerë dhe barinj. Fiset Veriore janë të izoluar nga vargje malore dhe kufi politike. Shumë nga Kolait kanë probleme të ndryshme shëndetësore për arsye të cilësive së dobët të ujit të pijshëm dhe keqshqyerjes. Uji i pijshëm, kanalizimet e ujërave të zeza, dhe sistemet e drenazhimit janë të disponueshme vetëm për 8% të popullsisë. Sot, pjesa më e madhe e popullsisë janë Sunni (ortodoksë) Myslimanë, dhe disa madje praktikojnë shamanizmin. Ata besojnë që ekziston një botë e padukshme demonësh, zanash dhe shpirta të të parëve, kështu që ata mbështeten në shamanët për të shëruar të sëmurët, për të folur me shpirtat dhe për të kontrolluar situatat.

Ide për lutje:

- ▶ *Adhuroni Zotin si të vetmin Çlirues të vërtetë nga fuqia e mëkatit, vdekjes dhe demonëve. Shpallni Jezusin si Zotin e vërtetë të fshatrave Kolai.*
- ▶ *Lutuni që Kolait do i japin favor atyre që çojnë Ungjillin.*
- ▶ *Kërkojini Perëndisë të ngrejë punëtorë të cilët mund të merren në mënyrë efektive me forcat shpirtërore që ekzistojnë në zonën Kolai (Marku 6:13, Veprat 10:38).*
- ▶ *Duhen njerëz që të ndihmojnë për çështjet sanitare dhe për çështjet e të ushqyerit.*



Myslimanët në New York City

“Perëndia, pra, duke kaluar përmbi kohërat e padijes, i urdhëron të gjithë njerëzit dhe kudo që të pendohen. Sepse ai ka caktuar një ditë në të cilën do të gjykojë me drejtësi botën me anë të atij njeriu të cilin ai e ka caktuar; dhe për këtë u ka dhënë të gjithëve një provë të sigurt, duke e ringjallur prej së vdekurish” (Veprat 17:30-31)

Në verën e vitit 2010 e gjithë bota i kishte sytë të drejtuar në New York City në Amerikë. Një xhami e re ishte propozuar të ndërtohej vetëm dy blloqe më tutje kantierit “11 Shtator Ground Zero” në Mahnatenin e poshtëm. Papritur i gjithë planeti e mori vesh që kishte Myslimanë në New York City. Shumica e Amerikanëve zbuluan për habinë e tyre që me shumë mundësi kishte rreth 600,000 Myslimanë në zonën e New York City po ashtu edhe mbi 100 xhami. Në vitin 1970 kishte më pak se dhjetë xhami. Një xhami, e cila ishte ndërtuar 5 blloqe larg nga kantieri “Ground Zero” madje humbi disa nga anëtarët e saj në sulmin e famshëm terrorist të vitit 2001.

Pavarësisht se çfarë ndiejnë dhe mendojnë njerëzit për iden e një xhami afër kantierit “Ground Zero”, ne si besimtarë jemi thirrur të gjithë të lutemi për përmbushjen e qëllimeve të Perëndisë midis Myslimanëve të New York City. Ai sigurisht që po thërret shumë Myslimanë të vijnë në Mbretërinë e tij të përjetshme. Gjaku i Jezusit u derdh për ta. Le të lutemi për Myslimanët në zonën e New York City.

Ide për lutje:

- ▶ *Hetoni zemrën tuaj lidhur me 11 Shtatorin. A të ka bërë ajo ngjarje të jesh më i hidhur, paragjykses dhe i zemëruar me Myslimanët në përgjithësi për shkak të atij sulmi? (Hebrenjve 12:15)*
- ▶ *Lutuni për familjet që kanë humbur të dashurit e tyre në sulmet e 11 Shtatorit. Lutuni që ata do të jenë në gjendje të bëjnë paqe me të shkuarën dhe do të jenë gati të bëjnë përpara për pjesën e mbetur të jetës së tyre, duke lënë çdo hidhërim mbrapa. Perëndia është i vetmi që mund t’i ndihmojë familjet që vuajtën këto humbje.*
- ▶ *Lutuni për anëtarë të komunitetit Mysliman në New York që kanë vuajtur nga paragjykimi dhe abuzimi për shkak të këtyre sulmeve, thjesht sepse janë Myslimanë.*
- ▶ *Mbani mend që në qiej bëhet një betejë shpirtërore për shpëtimin e shumë Myslimanëve në këtë qytet të*

cilët janë akoma të kapur fort në dorën e armikut. Ata kanë nevojë për çlirim nga faji dhe turpi i mëkatit, nga fuqia e vdekjes dhe nga frika e të ligut. “Sepse beteja jonë nuk është kundër gjakut dhe mishit, por kundër principatave, kundër pushteteve, kundër sundesve të botës së errësirës të kësaj epoke, kundër frymërave të mbrapshta në vendet qiellore” (Efesianëve 6:12).

- ▶ *Lutuni për Myslimanët në zonën e New York që do të zbulojnë të vërtetën për Mesian, Jezusin, nëpërmjet miqësive me besimtarët, nëpërmjet ndërhyrjeve mbina-tyrore dhe radiove tradicionale, televizionit, internetit, librave, fletëpalosjeve, DVDve dhe Biblës.*
- ▶ *Nevojiten shumë punëtorë të rinj. Besimtarë nga i gjithë New York nevojiten që të shpallin Lajmin e Mirë në komunitetin Mysliman.*



Al Jadida, Marok

Al Jadida Marok, është një qytet detar në bregdetin Atlantik të Marokut me mure guri masive. Portugezët kanë ndërtuar një qytet të rëndësishëm kështjellë, në vendin e quajtur Mazgan në vitin 1502 me qëllim që t'u bënin ballë piratëve lokalë. Myslimanët Marokenë e morën kështjellën nga Portugezët në vitin 1769. Myslimanët i vendosën qytetit emrin "Al-Jadida" që në arabisht do të thotë thjesht "i ri". Qyteti tani ka rreth 150,000 banorë. Al-Jadida gjallërohet plotësisht në verë. Shumë plazhe të mrekullueshme të zonës (Oualidia Haouzia, po ashtu dhe Sidi Bouzid, Lalla Fatma dhe Jorfi) tërheqin kryesisht pushuesit Marokenë por edhe një numër të vogël turistësh Perëndimorë. Pushuesit Marokenë dinë më së miri të relaksohen e të shijojnë pushimet.

Për më shumë informacion shihni faqen e internetit: www.ariseshinemorocco.org



Ide për lutje:

- ▶ *Gjatë dekadave shumë Marokenë në Al Jadida kanë dëgjuar dhe janë ndikuar nga Ungjilli nëpërmjet medias ose nga kontaktet e drejtpërdrejta me besimtarët. Shumë prej tyre kanë nevojë ti përkushtojnë/ri përkushtojnë jetët e tyre Mesias. Të tjerë kanë nevojë të pajtohen me besimtarët të tjerë. (Shih Jakobi 1:6-8 dhe 4:8).*
- ▶ *Lutuni për atë grup të shpërndarë besimtarësh të zonës që ata do të bëhen të guximshëm dhe do të kenë një dëshirë të thellë në zemër për të ndarë besimin me të tjerët dhe për tu mbledhur së bashku. Besimtarët Marokenë zakonisht nuk mblidhen bashkë rregullisht për shkak të frikës (Shiko 2 Timoteut 1:7).*
- ▶ *Lutuni për Marokenët që do të zbulojnë Mesian gjatë pushimeve. Ai është i vetmi që mund të sjellë paqen e vërtetë, gëzimin dhe çlodhjen. Vite përpara Apostulli Pjetër po qëndronte në bregdetin e Israelit. Aty ndodhën disa ngjarje dramatike të cilat bënë që të tjerë të takoheshin me Jezusin pak më tutje se bregu i detit (Shiko Veprat 10:1-48). Lutuni për ndërhyrjet e Perëndisë!!!*
- ▶ *Lutuni për këtë zonë bregdetare nga Azemour në Jadida në Safi në Essaourira. Fladi i Frymës së Shenjtë le të fryjë nga deti dhe të futet në brendësi të vendit drejt e në zemër të kombit.*

JEZUSI NË KURAN

Ju mund të zbuloni më shumë për perspektivën Islamike mbi Jezusin duke lexuar për të në Kuran. Disa kapituj (sure) dhe vargje i kemi veçuar më poshtë. Jezusit zakonisht i referohen me emrin Isa në Kuran. Tituj, role dhe aktivitetet të ndryshme i janë atribuar Jezusit. Ja disa shembuj:

Jezusi është fjala e Perëndisë:
Sure: 3:45; 5:46, 110 dhe 57:27

Jezusi është Mesia:
Sure: 3:45; 4:171; 5:17, 72, 75

Profeti ose Mesazheri nga Perëndia:
Sure: 3:49; 6:85; 19:30; 57:27

Ngriti të vdekurit dhe shëroi të sëmurët:
Sure: 3:49; 5:110

I Pastër, pamëkat:
Sure: 19:19

Megjithëse idetë e Kuranit të renditura më lart janë të njëjta apo të ngjashme me idetë e Biblës, Myslimanët asnjëherë nuk e mendojnë Jezusin si hyjnor apo që na shpëton nëpërmjet vdekjes dhe ringjalljes së tij. Ata e mendojnë atë si një profet i cili na solli një libër që quhet "Ungjilli."

Bazat e Islamit



Sipas Myslimanëve Islami filloi me dy njerëzit e parë, Adamin dhe Evën, të cilët duhet t'i nënshtroheshin Perëndisë. Fjala Islam do të thotë nënshttrim. Myslimanët besojnë që Abrahami, Moisiu, Davidi dhe Jezusi janë që të gjithë profetë të Islamit. Shumë Myslimanë madje besojnë që Adami ndërtoi të parën Beit Allah (shtëpinë e Perëndisë) në Mekë, Qabënë. Kjo strukturë prej guri, e mbuluar me një copë të zezë, ka ekzistuar për një kohë të gjatë. Ajo ka ekzistuar madje edhe gjatë jetës së Myslimanit më të famshëm, Muhamedit.

Askush nuk mund ta kuptojë Islamin pa ditur diçka mbi jetën e Muhamedit. Këtij burri të gjithë Myslimanët i referohen si profeti i fundit dhe më i madhi. Në Islam, Muhamedi konsiderohet si “njeriu ideal”. Në asnjë mënyrë Muhamedi nuk konsiderohet i shenjtë, dhe as nuk adhurohet, por ai është modeli për të gjithë Myslimanët se si ata duhet të sillen. Nuk lejohet asnjë shfaqje e imazheve të Muhamedit (me qëllim parandalimin e idhujtarisë).

Jeta e hershme e Muhamedit: Profeti i Islamit u lind në vitin 570 pas Krishtit në Mekë, një qytet në Arabinë Saudite.

Ai ishte anëtar i Klanit të Hashimit të fisit të fuqishëm të Kyraysh. Gjatë pjesës më të madhe të jetës pagane të Muhamedit adhurimi i idhujve u përhap në Arabi. Rreth 360 perëndi dhe perëndesha adhuroheshin nga Arabët në Mekë, që ishte qendra kryesore e idhujtarisë në rajon. Historianët Myslymanë mendojnë që edhe që fëmijë Muhamedi e urrente adhurimin e idhujve dhe jetoi një jetë të pastër morale.

Zbulesat e para: Sipas Myslimanëve, në moshën 40 vjeçare në vitin 610 pas Krishtit supozohet që Muhamedi filloi të merrte zbulesa dhe mesime të cilat ai besonte që ishin nga kryeengjëlli Gabriel (Xhebraili në Arabisht). Këto zbulesa përbëjnë bazën e Kuranit. Muhamedi shpalli që zbulesat e tij ishin mesazhet superiore dhe më të fundit nga I Vetmi Perëndi Suprem, ndonëse në fillim Muhamedi madje dyshoi nëse ai ishte apo jo profet. Ai e ndaloi adhurimin e idhujve dhe vendosi rregullin civil dhe fetar në Medinë dhe së fundi në Mekë. Muhamedi vdiq për shkaqe natyrore në vitin 632 pas Krishtit në Medinë, në Arabinë Saudite.

ÇFARË BESOJNË ISLAMIKËT

Një Perëndi, Krijuesi i gjithçkaje

Engjëjt dhe shpirtat e këqinj

Profetët (Adami, Noe, Abrahami, Moisiu, Davidi, Jona, Jezusi, Muhamedi)

Muhamedi profeti i fundit dhe më i madhi

Librat e Shenjtë: Torah, Zaburi (Psalmet), Inxhili (Ungjilli) dhe Kurani

Dita e Gjykimit për të gjithë njerëzit

Bibla është ndryshuar dhe modifikuar nga Judenjtë dhe të Krishterët

Marrëdhëniet me Judenjtë dhe të Krishterët:

Gjatë jetës së tij, Muhamedi takoi shumë njerëz të cilët ishin të paktën të Krishterë me emër. Ai gjithashtu mësoi shumë ide dhe zakone fetare nga klanet e Judenjve që jetonin në rajonin e Mekës dhe Medinës. Roli i Muhamedit si profet nuk u pranua nga Judenjtë, gjë që solli konflikte serioze. Ide, praktika dhe histori Jude dhe të Krishtera bëjnë pjesë në fakt në Kuran, ndonëse shpesh ato janë të shtrembëruara.

IDETË ISLAMIKE PËR JEZUSIN

- Jezusi u ngjiz në mënyrë të mrekullueshme nga Perëndia në mitrën e virgjreshës Mari.
- Jezusi është vetëm një profet, ai nuk është i hyjnor (nuk është Biri i Perëndisë, nuk është Perëndia në mish).
- Myslimanët besojnë që Jezusi madje foli kur ishte foshnjë dhe tha që ai ishte një profet.
- Sipas Myslimanëve Jezusi ishte në fakt një Mysliman i mirë dhe ai ju mësoi një formë më të hershme të Islamit popullit të Judenjve. Madje të dhëna për jetën Myslimane të Jezusit mund të gjenden në të ashtuquajturin “Ungjilli sipas Barnabës”. Ky dokument erdhi në formën që është sot dikur midis shekujve 14-16 pas Krishtit. Mund edhe të jetë shkruar në atë kohë.
- Jezusi do të vijë përsëri një ditë, ai do të martohet dhe ai do të lindë fëmijë. Ai do të korrigjojë gabimet që të Krishterët kanë thënë për të. Ai do të vdesë, do të varroset në Medinë dhe do të gjykohet në Ditën e Gjykimit.
- Jezusi nuk është gjykatësi i njerëzimit.



ISLAMI: VDEKJA DHE RINGJALLJA E JEZUSIT

- Islami mohon nevojën që Jezusi të vdesë për mëkatet tona. Shumë Myslimanë besojnë që Perëndia i Abrahamit thjesht mund të falë mëkatet pa një sakrificë shlyese.
- Islami e mohon faktin e vdekjes në kryq të Jezusit. Sipas mësimave të Islamizmit Jezusi shkoi direkt në parajsë pa vdekur. Ai nuk u kryqëzua. Myslimanët shpesh besojnë që fytyra e Judës, tradhëtarit, u transformua në fytyrën e Jezusit dhe ai vdiq në vend të Jezusit si një gjykim nga Perëndia.
- Islami e mohon efikasitetin e vdekjes së Jezusit për të na hequr ne mëkatin dhe fajin.
- Islami e mohon ringjalljen e Jezusit dhe fitoren e tij mbi vdekjen.
- Islami e mohon që Jezusi u bë Mbreti Mesianik i cili do të mbretërojë mbi gjithë botën.

PESË SHTYLLAT E ISLAMIT

Feja Islamike jetohet mbështetur në 5 “shtylla” kryesore të cilat janë praktika të detyruara fetare për të gjithë Myslimanët e rritur:

1. Recitimi i Kredos (shahada)—“Nuk ka Perëndi tjetër vec Allahut dhe Muhamedi është profeti i tij”.
 2. Lutja (salat)—5 herë në ditë.
 3. Dhënia e Lëmoshës (zekati)—Dhënie e detyruar dhe vullnetare për të varfrit.
 4. Agjrimi (saum)—Veçanërisht gjatë muajit “të shenjtë” të Ramazanit.
 5. Peligrinazhi (hajj)—Të paktën një herë gjatë jetës shkuarja në Mekë, që njihet si Hajj.
- Disa Myslimanë shtojnë një shtyllë të gjashtë:*
6. Xhihadi: Beteja për të përhapur besimin Islam në gjithë botën, ose me forcën e armëve ose duke u përpjekur aktivisht për përhapjen e besimit me anë të fjalëve dhe veprave.

Ajo që ka bërë Perëndia për ne:

Jezusi, Mesia, u ringjall prej së vdekurish, Princ i mbretërve të dheut... na ka çliruar nga mëkatet tona me anë të gjakut të Tij. (Zbulesa 1:5)

Ahuani i Indisë

Ahuanët janë një popull në Indi numri i të cilëve arrin në mbi 600,000 banorë. Ata flasin gjuhën Urdu. Pjesa më e madhe e Ahuanëve pretendojnë që rrjedhin nga Qutb Shahu, një gjeneral në ushtrinë e Mahmudit të Ghasnit, i cili është një pasardhës i kushërirrit dhe dhëndrit të Muhamedit, Aliut.

Ahuanët kanë një traditë të fortë luftarake dhe janë të njohur për trimërinë e tyre. Ata janë midis atyre popujve që Britanikët i etiketuan si “racat marciale” (një emërtim i krijuar nga zyrtarët e Indisë Britanike për të përshkruar popujt të cilët mendoheshin që ishin natyrshëm luftarakë dhe agresivë në beteja, dhe që kishin cilësi të tilla si kura-joja, besnikëria, forca fizike, qëndrueshmëria, ishin të pathyeshëm në luftim etj). Britanikët rekrutuan shumë nga këta njerëz të “racave luftarake” për shërbim në kolonitë e ushtrisë, dhe ata formuan grupet e para Myslimane të rekrutuara gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore.

Ide për lutje:

- ▶ *Shpallni që Perëndia është Zoti i Legjioneve (ushtrive) mbi Ahuanët dhe ata duhet ti binden Atij (Psalmi 103:19-22)*
- ▶ *Lutuni për çlirim nga vargonjtë e armikut.*
- ▶ *Kërkojini Perëndisë t’u zbulojë veten te Ahuanët nëpërmjet ëndrrave, vizioneve dhe manifestimeve të tjera. (Psalmi 103:2-3).*
- ▶ *Lutuni për punëtorë që do të shpallin Mesian midis Ahuanëve. (Artikulli është mbështetur në një material të organizatës Frontiers)*

Balrampur

Distrikti i Balrampurit është vendosur në Indinë veriore në shtetin e Utah Pradeshit, ngjitur me Nepalin. Tre qytetet kryesore të këtij Distrikti janë Balrampur, Utraula dhe Tulsipuri (mund ti shihni këto qytete në Wikipedia). Lumi kryesor që përshkon tej për tej distriktin, Rapti, është i dëgjuar për përmytjen vjetore, që u’ a vështirëson jetën njerëzve që banojnë në brigjet e tij. Më pak se 10% e njerëzve janë zotërues të mëdhenj tokash ndërsa 90% janë fermerë që fitojnë bukën e gojës me atë pak tokë që kanë, ose janë punëtorë në agrikulturë. Shumica e popullsisë është analfabete. Aktualisht e gjithë popullsia e ka të pamundur të jetojë vetëm nga toka, për këtë arsye shumë njerëz kanë migruar në qytetet të tjera të Indisë si Mumbai, Ahmedabadi dhe Jaipuri.

Gjuhët kryesore që fliten në Balrampur janë dialektet rustike të Hinduishtes, të njohura si Dehati dhe Urduja. Mbi 40% e Distriktit është Myslimane dhe 60% janë Hindu me shumë pak besimtarë në Mesian. Festivali Mysliman vjetor Muharan është i famshëm—shumë familje me origjinë nga ky distrikt kthehen çdo vit të festojnë me të afërmit e tyre. Në çdo fshat ka xhami por kisha s’ka asgjëkund. Myslimanët dhe Hindutë e Balrampurit jetojnë në harmoni dhe miqësi të ngushtë me njëri-tjetrin. Ka shumë pak punëtorë që po përpiqen të depërtojnë në komunitetin Mysliman dhe fatkeqësisht përpjekjet e tyre janë të pamjaftueshme për këtë zonë të madhe të paarritur.



Festivali Muharam në një zonë aty pranë.

Ide për lutje:

- ▶ *Lutuni që Perëndia do të sjellë besimtarë të pajisur mirë të cilët mund të flasin gjuhët lokale me qëllim që të punojnë në Balrampur.*
- ▶ *Lutuni që Perëndia do hapë zemrat që të pranojnë Ungjillin, veçanërisht në qytetet kryesore të përmendura më lart, si dhe në fshatrat e shumtë.*
- ▶ *Lutuni për ata që tashmë janë përfshirë në kurset biblike me korespondencë. Disa studentë janë shprehur që janë gati të besojnë në Mesian.*
- ▶ *Lutuni për sigurinë e besimtarëve po ashtu edhe për sigurinë e dishepujve të ardhshëm.*



Territoret Palestineze

Bregu Perëndimor: 5877 km²

Popullsia: 2.4 milion banorë

408 banorë për km²

19 kampe refugjatësh

Gjiri i Gazës: 365 km²

Popullsia: 1.5 milion

4108 për km²

8 kampe refugjatësh

Për Palestinezët që jetojnë në gjirin e Gazës, në Nablus (Sechemi i vjetër), në Hebron, Betlehem, në Ramallah dhe kudo tjetër, jeta është e vështirë. Mbijetesa ekonomike është e vështirë për shumicën e familjeve Palestineze në periudha normale, por marrëdhëniet konfliktuale ndërmjet Judenjve dhe Palestinezëve dhe ndërmjet vetë Palestinezëve i bëjnë gjërat akoma më të vështira. Familjet, pleqtë, dhe personat me aftësi të kufizuar janë ata që vuajnë më shumë.

Pavarësisht tërheqjes së tyre, prezenca e trupave ushtarake Izraelite në det dhe në kufirin e Gjirit të Gazës akoma perceptohet nga Myslimanët Palestinezë si pushtim nga Izraeli për shkak të vështirësisë së importimit të mallrave nga bota e jashtme për pjesën e brendshme të mbipopulluar. Nga ana Egjiptiane, marrja e vizave është jashtëzakonisht e vështirë. Shumica e popullsisë së Gazës, s'ka kaluar kurrë as midis kufijve të dy vendeve me Egjiptin, dhe nuk ka qenë as në Kairo, i cili është qyteti më i madh në botën arabe, dhe ndodhet vetëm 350 km larg. Bregu Perëndimor ndodhet akoma nën kontrollin e rreptë të Izraelit megjithatë fatmirësisht ka disa zona të veçanta me prosperitet. Ndërsa Palestinezët marrin ndihmë ekonomike nga jashtë, disa



“Mënyra më e mirë që kam për të ndihmuar Izraelin është t'i drejtoj armiqtë e tij te Jezu Krishti!”

— Vëlla Andrea

Ide për lutje:

► *Falenderoni Perëndinë që Ai nuk i ka harruar premtimet e Tij për Judenjtë dhe Arabët. Ai është besnik më të dy këta popuj; disa arabishtfolës (nga Arabia) dëgjuan për herë të parë për Mesian në ditën e Pentakostit. (Veprat 2:11). Është e dukshme që Perëndia dëshironte që ata të dëgjonin Lajmin e Mirë.*

► *Falenderoni Perëndinë për Palestinezët që tashmë e kanë njohur Perëndinë. Kërkoni në lutje që do të ketë më shumë që do ta njohin Perëndinë.*

► *Lutuni për një shërim të brendshëm e të dukshëm për shumë prej tyre. Shenjat e konflikteve të dekadave të tëra shkatërrojnë jetët e tanishme.*

► *Lutuni për militantët e grupeve Hamas dhe Fatah. Lutuni që zemrat e tyre të mund të ndryshohen. Lutuni që ata do të njohin dashurinë e Mesias. Simoni “ekstremist” ishte një nga dishepujt e Jezusit. Shumë ekstremistë, në kohën e Jezusit përdornin dhunën për të arritur qëllimet e tyre. (Mateu 10:4).*

► *Lutuni për besimtarët guximtarë që jetojnë midis Palestinezëve Myslimanë që ata të jenë një dëshmi e mirë (Mt.5:16). Lutuni që ata do forcohen në besimin e tyre. (Efesianëve 3:16-17).*

shtete gjithashtu iu dërgojnë armë, granata dhe raketa, gjë që e përkeqëson situatën. Kjo nxit dhunë të mëtejshme ndaj Izraelit.

Ndjejhet hidhërim, stres dhe urrejtje e madhe sepse pothuaj çdo familje ka patur një bir, nip, kushëri, baba, nënë apo motër që ka vdekur gjatë luftimeve, protestave, përlshjeve me armë, përpjekjeve dhe konfrontimeve terroriste, gjatë këtyre 65 viteve të fundit. Edhe midis Arabëve, luftërat midis grupeve të tyre ushtarake dhe politike (Hamas dhe Fatah) kanë vrarë qindra njerëz, (vetëm nga viti 2006 deri në vitin 2007 brenda 18 muajve kanë vdekur rreth 600 njerëz). Sigurisht, vetëm Perëndia mund të ndryshojë njerëzit dhe të largojë urrejtjen dhe hidhërimin.

Rreth 2500 njerëz në Gaza e quajnë veten besimtarë. Megjithatë shumica prej tyre nuk e praktikojnë besimin, ndonëse disa besimtarë të përkushtuar janë martirizuar për besimin e tyre. Disa besimtarë aktivisht kanë ndihmuar të vejat, pleqtë dhe personat me aftësi të kufizuar. Besimtarët e Gjirit të Gazës kanë padyshim nevojë për inkurajim. Vizitorët e jashtëm që shkojnë në Gazë tregojnë sesi zemrat e tyre preken dhe sesi ata ikin duke lotuar, “Besimtarët në Gaza i'u thonë ‘Mos na harroni.’”



Al-Masjid Al-Aqsa

Vendi i tretë më i shenjtë i Islamit

Sipas traditës Islamike, gjatë vitit 621 pas Krishtit, Muhamedi, Profeti i Islamit, ishte në Mekë dhe ai ose pati një vizion ose një udhëtim të mrekullueshëm të trupit që e quajti “Udhëtimi i Natës”. Supozohet që ëngjëlli Gabriel erdhi tek ai me një kalë fluturues të quajtur Buraq i cili kishte një fytyrë njerëzore. I hipur në këtë kafshë të çuditshme, Muhamedi fluturoi përmes ajrit për në Jeruzalem. (1200 km ose 750 milje). Në Jeruzalem, në Malin e Tempullit supozohet që Muhamedi udhëhoqi në lutje profetët e tjerë që u shfaqën aty, Moisiun, Jezusin, Adamin. (Tempulli ishte shkatërruar 551 vjet përpara në vitin 70 pas Krishtit.)* Pastaj supozohet që Muhamedi i rihipi Buraqit dhe shkoi lart në qiej në prezencën e Perëndisë, ku ai bëri marrëveshje me Perëndinë që të faleshin (luteshin) vetëm pesë herë në ditë. Supozohet që Perëndia kishte kërkuar të faleshin 50 herë në ditë. Pas kësaj thuhet që Muhamedi u kthye në Mekë dhe ua përshkroi udhëtimin e tij të tjerëve. Shumica e njerëzve nuk e besuan.

Vendi në cepin më jugor të Malit të Tempullit ku supozohet që Muhamedi u lut gjatë “Udhëimit të Natës” u bë i njohur si “xhamia më e largët” që është kuptimi arabisht për Al-Masjid Al-Aqsa. Xhamia aktuale u përfundua në vitin 705 pas Krishtit dhe u rindërtua disa herë për shkak të tërmeteve. Sipas traditës, “Kubeja



Xhamia Al-Aqsa

Kubeja e Shkëmbit

Fokus: Lutja e së Premtes

e Shkëmbit (The dome of the Rock)” e cila ndodhet në krah të xhamisë Al Aqsa, tani mbulon vendin nga ku Muhamedi supozohet që u nis për në qiej.

Xhamia Al-Aqsa thuhet që është vendi i tretë më i shenjtë fetar për shumicën e Myslimanëve. Sipas një tradite, vetë Muhamedi ka thënë që një lutje islame e bërë në Qabënë e Mekës është e barabartë me 100,000 lutje; një lutje e bërë në Medinë është e barabartë me 1000 lutje; dhe një lutje e bërë në xhaminë Al-Aqsa në Jeruzalem është e barabartë me 500 lutje më shumë se në çdo vend tjetër. (Sigurisht që të Krishterët nuk e mendojnë lutjen që të ketë ndonjë vlerë tjetër përveç vlerës së bashkësisë dhe komunikimit).

***Myslimanët luteshin çdo ditë duke u drejtuar nga Jeruzalemi deri në vitin 624 pas Krishtit kur Myslimanët filluan të luteshin duke u drejtuar nga Meka.**

Ide për lutje:

Mijëra Myslimanë marrin pjesë në lutjet javore të të Premtes në xhaminë Al-Aqsa, e cila në pjesën e brendshme ka një kapacitet për 4000 njerëz. (dhjetra mijëra luten në oborrin e jashtëm gjatë aktiviteteve kryesore fetare.) Për arsye sigurie, Izraelitët i kanë kufizuar pjesëmarrjen në lutjet e të premtes vetëm burrave të vjetër që kanë familje. (Disa prej tyre janë kryefamiljarët në familjet e tyre)

- ▶ *Lutuni për burrat që marrin pjesë në lutjet e të Premtes. Lutuni që Perëndia do të zgjojë mendjet e tyre dhe që ata do të duan të dinë se çfarë ndodhi në tempullin e lashtë të Izraelit (fokusohuni te Mateu 27:51). Ata kanë nevojë për një zbulësë për të kuptuar që vetëm Jezusi mund t'i çojë njëzëit tek Ati. (Gjoni 14:6).*
- ▶ *Adhuroni Perëndinë, shpallni Jezusin, Birin e Perëndisë, mbretin e Izraelit si Zotin mbi Myslimanët të cilët vijnë për t'u lutur. (Gjoni 1:49).*
- ▶ *Lutuni gjithashtu për familjet e tyre që do të vijnë në mbretërinë e Perëndisë. (Gjoni 3:3).*



Hezbollah

Banorët e tanishëm të Gazës kanë shumë pak ose aspak lidhje me Filistenjtë e lashtë. Emri Palestinë është një deformim Romako Latin i fjalës Filistinë, sidoqoftë Arabët modern Palestinezë nuk janë Filistenjtë.

Emri Palestinë u dha nga Romakët për Judën pas revoltës çifute të 135-ës pas Krishtit. Në Arabisht fjala Palestinë gjërmëzohet "Falastin" e cila është e ngjashme me Filistin. Nuk ka "p" në Arabisht. Disa Palestinezë Arabë thonë se janë Filistenjtë duke ditur që ka pasur luftë midis Izraelit dhe Filistenjëve. Disa e bëjnë këtë për të nxitur urrejtje, disa thjesht se janë të keqinformuar.

Në realitet Filistenjtë origjinalisht kanë ardhur nga rajoni i Kretës në Detin Mesdhe dhe u vendosën në bregdet. (Zan 10:14, 1 Kron 1:9-15). Filistinët nuk ishin të gjithë nga Arabia. Ka disa tekste Biblike që profetizojnë për shkatërimin e Filistenjëve dhe civilizimin e tyre. (Jer 47:1-7, Ezek 25:15-17 dhe Joel 3:4-6). Para Krishtit pushtimi nga Egjiptianët, Asirianët, Babilonasit, Persianët dhe Grekët nën Aleksandrinë, asgjësuan efektivisht Filistenjtë. Më vonë Romakët, Bizantinët, Arabët, Kryqëzuesit, Turqit dhe Anglezët pushtuan zonën. Njerëzit, kultura, qeveria gjuha dhe feja Filistine u zhdukën.

Hezbollah është një organizatë politike, sociale dhe ushtarake në Liban e cila filloi në 1982. Emri Hezbollah do të thotë "Partia e Perëndisë". Si një organizatë Shi'ite, Hezbollah ka marrë mbështetje të fortë fetare, financiare, politike dhe ushtarake nga Irani. Siria gjithashtu e ka përkrahur Hezbollahun politikisht dhe praktikisht. Organizata është shumë e pranishme në Luginën Beqa, në jug të Bejrutit dhe në jug të Libanit. Është një forcë politike e rëndësishme dhe ka zhvilluar një rrjet shërbimesh sociale shumë të forta dhe aktive.

Disa qeveri botërore e konsiderojnë Hezbollah si një organizatë terroriste, duke përfshirë SHBA, Australinë, Kanadanë, Izraelin dhe Anglinë. Hezbollah dënoi sulmin në Qendrën Botërore të Tregtisë në 2001, por është akuzuar për sulmet vetvrasëse (ose tentativat për sulme) në të kaluarën. Hezbollah mohon përfshirjen në çdo sulm. Levizja Shiite Hezbollah nuk ka asnjë lidhje me Al Kaedën (një levizje Suni). Midis Arabëve, zakonisht Hezbollah është parë si organizatë rezistence ligjore në Liban e cila është ngritur vazhdimisht ndaj forcave ushtarake të Izraelit (65% deri 85% ishin në favour të Hezbollah sipas disa sondazheve). Sidoqoftë, disa qeveri në Lindjen e Mesme, duke përfshirë Egjiptin, Arabin Saudite dhe Jordanin, e kundërshtojnë Hezbollah si një "orga-



nizatë e papërgjegjshme dhe aventuroze" Nëpërmjet bashkëpunimit të vet me Iranin dhe Sirin, Hezbollah ka grumbulluar shumë armë rezervë në Liban (ndoshta katër herë më shumë armë se sa kishte përpara konfliktit të 2006-të të Libanit me Izraelin). Hezbollah e konsideron Izraelin një shtet të paligjshëm dhe i justifikon veprimet ndaj Izraelit si Xhihad mbrojtës.

Ide për lutje:

► *Lutuni për drejtuesit Hezbollah: Sheikh Muhammad Hussein Fadlallah, Hassan Nasrallah, Naim Qassem, dhe drejtuesit më të vegjël që të zbulojnë jetën që është vetëm në Jezusin (Gjon 1:9-14, 1 Gjon 1:4). Këta burra kanë nevojë të zbulojnë planin e Perëndisë për të bekuar botën nëpërmjet farës së Abrahamit (Gal 2:13-14 dhe 26-29).*

► *Ka ndoshta 7,000-10,000 vullnetarë dhe luftëtarë Hezbollah që janë gati për konflikt të armatosur me Izraelin. Lutuni që drita e Perëndisë do të vijë mes tyre, që ata të zbulojnë Mesian. Jezusi është i vetmi që mund të përbushë përfundimisht aspiratat e tyre për një botë të drejtë të sunduar nga Perëndia i vërtetë i Abrahamit. (Isaia 65:17 dhe 2 Pjet 3:13).*



Përmbytjet e Pakistanit

Sot është dita e Pavarësisë së Pakistanit



Fatkeqësit më të këqija natyrore të Pakistanit në Korrik & Gusht 2010 u përshkruan si një “tsunami i ngadalhtë”. Katastrofa katandisi 5 milion Pakistanez në të pastrehë dhe mbi 1600 vdiqën. Mbi 20 milion kishin nevojë për ndihma humanitare - ushqime, strehë dhe përkujdesje emergjente. 1/5 e Pakistanit ishte nën ujë. Përhapja e kolerës dhe dizanterisë shkaktojë sëmundje vdekjeprurëse notuese. Numri i njerëzve të raportuar që vuanin nga diarre akute shkonte në qindra mijëra.

Megjithatë kjo fatkeqësi hapi mundësi për të treguar dashurinë e Perëndisë popullit Pakistanez dhe për tu shërbyer atyre në emrin Jezus. Shumë kuptuan se ndihma erdhi nga të Krishterët lokalë. Një zyrtar lokal Pakistanez komentoi “Unë i vlerësoj përpjekjet e njerëzve të krishterë, ju gjithmonë jeni të parët për të ndihmuar në kohë nevojë dhe shërbeni pa asnjë lakmi.”

Në fund të një shpërndarjeje, një burrë nga një fshat lokal i tha punëtorëve të Krishterë, “Unë kurrë s’kam takuar të Krishterë në jetën time. Ky është shansi im i parë të shoh një të Krishterë, por ju dukeni si ne. Punëtori i Krishterë i tha atij se ata ndiqnin Isajen (Jezusin). Burri u përgjigj, “Asnjë person nga besimi im nuk erdhi të na ndihmonte, por ju erdhët nga një vend i largët. Me siguri ju jeni ndjekës të vërtetë të Isajes” (Emri Islamik për Jezusin). Një burrë tjetër pasi punoi përkrah një skuadre të Krishterë për një muaj tha, “Nuk ka shpëtim pa Isajën, Mesinë” (Jezusin,

Mesinë) Ai kishte qënë duke kërkuar të vërtetën për dy vjet.

Sidoqoftë nuk kishte vetëm lajme të mira në Pakistan. Sipas një drejtuesi, “Disa refugjatëve të Krishterë iu mohua haptasi ndihma, ndërsa të tjerëve iu kërkuva të ktheheshin në Islam. Ju mund ta imagjinoni atë zgjedhje të tmerrshme: “ose të braktisësh besimin tënd ose ti nuk mund të ushqesh fëmijët e tu.”

Ide për lutje:

▶ *Lutuni për punë afatgjatë restauruese nëpër gjithë Pakistanin. Lutuni për gjithë viktimat e përmbytjes – ata që janë në zi, të lënduarit dhe ata që kanë humbur shtëpitë dhe jetesën. Shumë kanë humbur pasurinë shtëpitë dhe bizneset e ngritura nga breza të tërë. Lutuni që të gjithë të gjejnë strehë të përshtatshme, ujë të pastër dhe ushqim. Ata kanë nevojë për shpresën që vjen nga premtimet e Perëndisë.*

▶ *Lutuni për të Krishterët në Pakistan, shumica e të cilëve janë në varfëri të skajshme. Lutuni që të njohin ngushëllimin dhe sigurimin nga Ati i tyre qiellor.*

▶ *Lutuni për besimtarët e rinj që njohën Mesian gjatë përmbytjes. Ata kanë nevojë për dishepullizim dhe të kuptojnë dashurinë e Perëndisë dhe të Mesias.*

▶ *Lutuni për ata besimtarë që kërkojnë të sjellin shpresë, jetë dhe paqe në rrethanat e vështira.*



Surat në Gujarat, Indi

Sot është dita e Pavarësisë së Indisë.



Dr. Syedna Mohammed Burhanuddin,
një drejtues Daudi Bohras

Në të gjithë botën Myslimanët Daudi Bohras numërojnë rreth një million. Ata banojnë në Indi, Pakistan, në Lindjen e Mesme, në Afrikën Lindore, dhe në Indinë Perëndimore në shtetin Gujarat. Në Indi Daudi Bohras njihen nga veshjet e tyre: burrat kanë mjekra dhe kësupla të bardha e të arta, me kurta të bardha të gjata, gratë veshin burkas me dy pjesë të qëndisura dhe me ngjyra.

Surat, në Shtetin Gujarat njihet si kryeqyteti tipik për Daudi Bohras. I vendosur në brigjet e lumit Tapi, qyteti antik portual i Suratit është i njohur për mëndafshin e tij delikat, brokadën elegante dhe tregtinë e erzave. Surat ishte një nga qytetet me më shumë prosperitet në Indi në shekullin e 17 dhe 18. Kompania e Indisë Lindore ngriti magazinat e saj të para në Surat në 1612. Fjala “Bohra ka derivuar nga Gujarati “vohorvu”, që do të thotë “të tregtosh”. Shumica e Bohrave janë tregtarë në fusha të ndryshme të biznesit.

Shteti i Gujaratit ka pasur fatkeqësi natyrore si thatësi, ciklone, përmbytje, dhe tërmete në dekadën e fundit. Surat u prek shumë nga tërmeti dhe përmbytja që shkatëroi shumicën e Gujaratit, dhe ka përjetuar trazira (revolta) shoqërore disa herë. Surat është një qytet i shpërthyesëm – janë të njohura tensionet që ndizen

shpesh në këtë zonë midis Hinduve dhe Myslimanëve. Trazirat fillojnë me pretekstin më të vogël, pronat shkatërrohen, dhe jetët e njerëzve merren pa ndonjë shqetësim apo pretendim.

Surat është një qytet shumë i e rëndësishëm për Daudi Bohras meqenëse aty trajnohen të gjithë punëtorët fetare për shërbesën e Bohrave. Ka një universitet Bohras të mirënjohur veçanërisht i specializuar për këtë qëllim në Surat. Studentët më të mirë vijnë nga i gjithë vendi, dhe është një nder të zgjidhesh për tu trajnuar në këtë Universitet. Komuniteti Bohras është veçuar, izoluar, dhe i paaritur me Ungjillin. Për disa vite një skuadër është lutur dhe i ka kërkuar Zotit për njerëz që do të shkojnë të arrijnë Bohrahet dhe Muslimanët e Suratit. Për momentin është bërë shumë pak punë për të shpallur Mesian midis Bohrave dhe Myslimanëve në Surat. Surat është një qytet që ka shumë nevojë për dritën e Ungjillit. Paqebërësit mbjellshin një të korrë drejtësisë midis Muslimanëve të Suratit.



Ide për lutje:

- ▶ **Adhuro Zotin siguresin tonë, Jehovah Jireh (Zan.22:14). Lutu kundra shpirtit të materializmit që depërton në jetët e Bohrave. Kërkojini Zotit të shfaqë Vetën si Siguresi Perfekt.**
- ▶ **Lutu që Perëndia të levizë në mënyrë mbinatyrore midis Bohrave në Surat. Lutu që ata të shohin ëndrra dhe visionet prej Perëndisë së Gjallë.**
- ▶ **Lutjuni Zotit të të korrave për më shumë punëtorë të vijnë midis Bohrave në Surat. Lutjuni për urtësi për drejtuesit dhe që njerëzit e duhur do të vijnë të bashkohen me ta në punë.**
- ▶ **Lutu për një qëndrim përluljeje midis Bohrave**
- ▶ **Lutuni që Princi i Paqes do të qetësojë tensionet midis Myslimanëve dhe Hinduve në Gujarat. Të dy kanë nevojë të mësojnë rrugën e paqes**
- ▶ **Lutu për biznese të reja të vijnë në komunitet.**

Myslimanët nëpër botë

Radhëit sipas
popullsisë Myslimane

Emri i vendit

Popullsia (në milion)

Përqindja e Myslimanëve

Tendenat fetare
Sunni / Shi'a

"Atij iu dha sundimi, lavdia dhe mbretëria, me qëllim që gjithë popujt, kombet dhe gjubët t'i shërbenin; sundimi i tij është një sundim i përjetshëm që nuk do të kalojë, dhe mbretëria e tij është një mbretëri që nuk do shkatërrohet kurrë". Danieli 7:14

Myslimanët sipas kontinenteve	Popullsia
Afrika	429 million
Lindja e mesme	250 million
Azia	800 million
Evropa*	44 million
Amerika	5 million
Totali	1.5 billion

*(Është përfshirë edhe Rusia)

Fetë kryesore në botë

Budist: 478 milion

Fetë Tradicionale Kineze: 410 milion

Animizmi/Fiset Afrikanë/të tjera: 311milion

Hindu: 959milion

Jofetar/Ateist: 938 milion

Myslimanë të të gjitha llojeve: 1.58 bilion

Kristianë të të gjitha denominacioneve: 2.2 bilion

1	Indonezia	233	80.3%	187	Sunni
2	Pakistani	185	95.8%	177	Sunni/Shi'a
3	Bangladeshi	165	89%	146.5	Sunni
4	India	1,215	14.2%	172.5	Sunni / Shi'a
5	Irani	75.1	98.6%	74.1	Shi'a
6	Egjypti	84.5	86.6%	72.3	Sunni
7	Turqia	76	96.7%	73.2	Sunni/Shi'a
8	Nigeria	158.3	45%	71.5	Sunni
9	Algjeria	35.5	97.3%	34.5	Sunni
10	Maroku	32.8	99%	32.7	Sunni
11	Iraku	31.5	96%	30.2	Shi'a
12	Afghanistani	29.2	99%	29.1	Sunni
13	Sudani*	43.5	61.4%	26.6	Sunni
14	Kina	1,331	1.9%	24.9	Sunni
15	Arabia Saudite	26.3	92.4%	24.3	Sunni
16	Uzbekistani	27.8	85%	23.6	Sunni
17	Jemeni	24.3	99%	24.3	Sunni/Shi'a
18	Siria	22.5	90%	20.3	Sunni
19	Malajzia	28	63%	17.5	Sunni
20	Nigeria	16	97%	15.5	Sunni

*Sudani Jugor pritet të marrë pavarësinë në Korrik 2011

◆ Nju Jork fq. 12

Amerika veriore

Amerika Jugore

Në Dhjetor të 2010 një burrë që punonte me Facebook-un bëri një prezantim gjeografik të lidhjeve të Facebook-ut përreth botës. Vini re numrin e gjerë të lidhjeve në Afrikën Veriore, Turqi, Liban, Pakistan, Bangladesh dhe në zonën e Indisë veriore. Ka një përqendrim mahnitës të përdoruesve në



Zona e kësaj harte e rrethuar me të bardhë njihet si dritarja 10/40 (Nga paraleli 10° deri 40° në hartën e botës). Në këtë zonë ndodhen shumica e njerëzve të botës që akoma nuk janë arritur me Ungjillin.

Malajzi, Indonezi dhe në Ishujt Filipine në jug. Ndërsa shumica e këtyre lidhjeve janë lokale kjo tregon sesi Myslimanët po e integrojnë gjithmonë e më shumë veten në komunitetin botëror. Shumë të rinj Myslimanë kanë njohuri të mira për yjet e botës muzikore pop si dhe për filmat ndërkom-bëtarë. Bota po ndryshon.



Afrika veriore



Lindja e mesme



Pakistan, Indi, Bangladesh



Malajzi, Indonezi, Filipine

Libia *(Kjo histori e imagjinuar është bazuar në ngjarje të vërteta)*

Artikulli original u shkrua përpara revoltave të Libisë kundra Muamar Gadafi

Rashidi ulet duke parë mbi Mesdheun. Prapa tij është Shkretëtira e Saharasë. Pesë fëmijët e tij po luajnë të lumtur ndërsa gruaja e tij po pastron sgarën. Rashidi është i shqetësuar. Ai normalisht kënaqet me barbekunë në motin e ngrohtë pranveror, duke biseduar me miqtë e tij, duke pirë çaj menteje dhe duke u qetësuar pas një javë të vështirë. Kjo javë ishte veçanërisht e vështirë pasi një ligj i ri u kërkon bizneseve si i tij të reregjistrohen, që do të thotë orë të tëra në rradhë, dhe Rashidi nuk është i sigurtë nëse e ka kuptuar mirë ligjin e ri. Metodatat progresive janë të reja për vendin e tij, ku korrupsioni dhe favorizimi shpesh do të thotë se pasuria e bollëkshme e naftës nuk jep asnjë përfitim për njerëzit e zakonshëm. Një udhëtim trajnimi në Evropë e ka shokuar Rashidin – ndërtesat, rrugët, në fakt gjithçka duket se riparohet vazhdimisht, dhe nuk lihen të shkatërrohen si në vendin e tij.

Por asnjë nga këto nuk e shqetëson Rashidin. Mjedisi fizik nuk është i rëndësishëm, Çfarë Allahu dëshiron, do të ndodhë. Rashidi e di se emri i tij do të thotë “I drejtuar me drejtësi”. Ai është krenar të mendojë për veten si një Njeri që është në shtegun e duhur. Sigurisht, askush s’mund të jetë i sigurtë me Allahun, por Rashidi është shumë i sigurtë se po bën gjithçka që do Allahu: ai lutet, argjeron, paguan taksat, dhe në çdo mundësi ai shpall besimin e tij në Allahun. Për një ose dy vjet ai do të jetë

i aftë të paguajë për të shkuar në Mekë. Por ndërsa mendon për udhëtimin që pati në Evropë, dhe veçanërisht për një nga mësuesit e tij Evropianë, gjithë siguria e tij mjegullohet. Mësuesi nuk jetonte ashtu si Rashidi priste, dhe ai i tha Rashidit në një nga ato bisedat me çaj se Perëndia nuk është i interesuar së pari në atë që në bëjmë por në pranimin tonë të asaj që ai ka bërë përmes Mesias! Ai dukej i sigurtë se do të jetonte me Perëndinë kur të vdiste! Si mund të ndodhtë kjo? Ai i kishte sugjeruar Rashidit të shikonte një stacion televiziv Arab. Për të treguar mirësjellje Rashidi i kishte marrë shenim të gjitha detajet. Tani ndërsa ishte në shtëpi ai nuk mund të ndalonte së menduari për të, dhe më në fund, një natë shumë vonë kur askush s’mund ta shihte, ai gjeti kanalën dhe duke u ndjere fajtor e pa për disa minuta, duke qënë i friksuar se mos e zbulonte dikush.

Tani Rashidi ka një problem më të madh. Mesazhi e tërheq atë, i pëlqen, por kjo për të është gjë e gabuar. Ai ka menduar që në fëmijëri se të Krishterët besojnë në tre perëndi, se librat origjinalë të Jezusit, Moisiut dhe Davidit kanë humbur ose janë ndryshuar nga Judenjët dhe të Krishterët. Si mundet ky mesazh, i cili është i dukshëm se ata e kanë marrë nga libri, mund të jetë e vërteta nga Perëndia?



Mirësia

Mirësia e Perëndisë na drejton drejt pendesës. (Rom 2:4)

Ide për lutje:

- ▶ *Ka me qindra Libian që kanë humbur të afërm dhe miq në revoltat e 2011. Gjetshin ata ngushëllim dhe ndihmë në Mesian.*
- ▶ *Lutuni kundra korrupsionit dhe që vendi të administrohet më mirë në të ardhmen. (Eks. 23:8, Ligj. për. 16:19).*
- ▶ *Lutuni për udhëtarët dhe refugjatët nga Libia që të takojnë të Krishterët të vërtetë që tu dëshmojnë për besimin e tyre (Vep 8:26-39).*
- ▶ *Lutuni për Libianezët të lidhen me programet në radio, në televizionet satelitore dhe programet në internet. Këto ndihma mediatike efektive kanë ndihmuar shumë të gjejnë besimin. Perëndia është duke shfaqur veten!*
- ▶ *Lutuni që Fryma e Shenjtë t'u zbulojë të vërtetën Libanezëve pavarësisht nga idetë e tyre të gabuara dhe vështirësitë. Shikoni pray4libya.net për më shumë informacion.*

Dëshmi nga Turqia

Një grua e re me një prejardhje konservative Myslimane është tani një ndjekëse e Krishtit. Vëllai i saj dëgjoji për këtë dhe ishte i sigurtë që së shpejti do të kthehej sërish tek Islami. Kur pa se ajo nuk ishte kthyer, ai i kërkoi që ta refuzonte besimin e saj dhe të thoshte kredon Islamike. Ajo refuzoi dhe ai mori një shkop hekuri dhe e kërcënoi me vdekje. Familja e tij e ndaloi atë por nëna e saj me dënësë dhe përgjërëm ju lut të thoshte kredon. Ajo e bëri më në fund por u pendua më pas. Kur ajo ndau me një besimtare tjetër hidhërimin e saj, mikja i shpjegoi se edhe Apostulli Pjetër e mohoi Jezusin, por u fal dhe u restaurua. Ajo ka përjetuar të njëjtin hir dhe thotë se: “Unë kurrë s’kam për ta mohuar Zotin sërish.”

Kohët e fundit një besimtar i pagëzuar që sapo kishte Kdalë nga burgu ishte i shqetësuar nga pyetjet që një person kishte ngritur rreth besueshmërisë të Dhiatës së Re. Ai tha se ishte i mbushur me dyshime dhe fjeti me Biblën afër krevatit. Në mes të natës ai u zgjua nga një burrë i cili iu drejtua Biblës dhe tha: “Mos ki frikë. Lexo librin tim. Unë jam gjithmonë me ty.” Më vonë ai kuptoi se ishte Jezusi që i kishte folur dhe ishte shumë i inkurajuar.



Një familje ishte e shqetësuar për Saitin, një kushëri Ndyzet vjecar i cili ishte mendërisht i trazuar dhe në vazhdimësi endej rrugëve të qytetit. Më një përpjekje të dëshpëruar për të gjetur ndihmë, ata morën një makinë me qira dhe e çuan në një bashkësi besimtarësh, në një qytet të madh e cila drejtohej nga një pastor Turk me emrin Ali. Saiti ishte i palarë dhe kishte një mjekër të gjatë e të ashpër, pantallonat që i kundërmonin urinë dhe kishte thonjë të gjatë mbi dy centimetër. Ai nuk mund të fliste dhe dukshëm jo mirë mendërisht. Të afërmit e pyetën Aliun nëse mund të bënte dicka për ta ndihmuar. Ai ju Përgjigji: “Jezusi mund ta ndihmojë, por ju duhet të besoni se Ai mund ta ndihmojë.” Ata thanë, nëse nuk do të besonim a do të bënim pesë orë rrugë për të ardhur tek ti? Kjo ishte e mjaftueshme për Aliun dhe shkoi tek burri me mjekër, i dha një përqaftim dhe u lut për të. Saiti i habiti ata duke u kthjelluar dhe foli për herë të parë pas pesë vjetësh! Një javë më vonë, Aliu dhe besimtarët morrën një telefonatë nga familja e tij duke thënë se ai është i pastër tani, ha mirë, nuk endet më rrugëve dhe është përsëri i kthjellët në mënjden e tij.

Populli Kangean

Sot është Dita e Pavarësisë për Indonezinë



Populli Kangean (popullsia 135,000) jeton në ishullin Kangean të Indonezisë me vendndodhje në veri të Balit. Ishulli ka një potencial të madh turizmi. Plazhet e tij në Detin Java janë piktoreskë dhe të pa prekur, dhe dendësia e pyjeve Veriore të Kangeasë kanë shumë kafshë dhe zogj të bukur. Majmunët, dragonjtë Komodo dhe gjarpërinjtë janë me shumicë. Zejtarët lokalë shesin punime dore.

Që prej 1993 ishulli ka qënë vënd i shpimeve për gazin natyror. Ata janë të lidhur me Javën lindore përmes një tubacioni gazsjellës 430 kilometra të gjatë ku pjesa më e madhe e tij është nën ujë. Buri me të tjera ekonomike të ishullit përfshijnë drurin tik, arrat e kokosit dhe kripën. Përtej zhvillimit të lidhur me tubacionin mbeten shumë zona të pa zhvilluara dhe udhëtarët që janë duke kërkuar për Aventura mund ta gjejnë shumë lehtë veten në shtëpi këtu. Kangeanët janë një nga 200 grup popujt e fundit Myslimanë me mbi 100.000 njerëz pa një përpjekje për të themeluar një komunitet besimtarësh.

Ide për lutje:

- ▶ Perëndia e zbuloftë veten e tij! (Luka 10:21-24).
- ▶ Adhuron Perëndinë, Shpalleni Psalm 97:1 mbi cdo ishull.
- ▶ Kërkojini Perëndisë të hapë dyert e mundësisë që Lajmi i Mirë të shihet, dëgjohe dhe të prezantohet mes Kangeanëve (Mark 16:15-19).
- ▶ Lutuni për Kangeanët të lexojnë Shkrimet, të shohin filma të Ungjillit dhe të ndërveprojnë me besimtarët në gjuhën e tyre.

Kerinci i Indonezisë

Urtësia e Perëndisë (Fj. e Urta 8:25):

“Më prodhuan para se themelet e maleve të ishin përforcuar, para kodrinave.”

Fillimisht nga brigjet lindore të Sumatrës, Kerincët u larguan nga sulltanati lokal Mysliman në një luftë të lashtë dhe u vendosën në tokën e tyre egzistuese lart në Malet Bukit Barisane. Ata flasin Kerinci dhe Bahasanë Indoneziane. Shumica e 260,000 Kerinceve janë fermerë që kultivojnë orizin, patatën, kafënë, kanellën, dhe madje rreshirën dhe bastunët e palmës nga zonat e xhunglës. Ata që jetojnë afër liqenit Kerinci dhe liqeneve të tjera të vogla merrin me peshkimin. Kerincët i kanë rezistuar asimilimit ndaj njerëzve të fortë të ultësirës. Sot po ndryshon izolimi tyre përmes masave të sponsorizuara nga qeveria që kanë zhvendosur njerëz nga Java, Sunda, dhe Bali për projektet e plantacioneve në tokën e tyre të pasur. Për

më shumë, një park kombëtar i standarteve botërore po zhvillohet nga “World Wildlife Fund” për të ruajtur pyjet tropikale, florën dhe faunën. Islami është feja më e madhe në Kerinci, por ata përsëri i mbahen fort animizmit veçanërisht siç paraqitet nga përdorimi i shëruesve tradicionalë dhe magjistarëve për të bekuar të korrat.

Ide për lutje:

- ▶ Kërkojini Zotit t’ju japë urtësi dhe favor besimtarëve që shkojnë tek Kerincët.
- ▶ Lutuni për urtësinë dhe autoritetin e Perëndisë për tu marrë me forcat shpirtërore që kanë mbajtur njerëzit të lidhur brez pas brezit (1 Kor. 1:30, 2 Kor. 10:4).





Touba dhe Mourides

Sufizmi është një lëvizje e përqëndruar në një dimension mistik të brëndshëm të përjetimit meve shpirtërore të Islamit. Shpesh Sufistet kanë kërkuar të hyjnë në prezencën e hyjnisë që të pastrohen nga brenda. Në përgjithësi lëvizjet Sufi janë drejtuar nga njerëz shumë të nderuar. Disa Myslimanë tradicionalë duke përfshirë edhe lëvizjen kryesore Vahabis në Arabinë Saudite i konsiderojnë Sufistët si heretikë.

Shumica e Myslimanëve në Senegal dhe në Gambia janë të lidhur me vëllazëritë Sufi si Tixhanijahët, Xhadirët (Kadirija) Mouridët dhe Lajnehët. Grupime të vogla janë formuar në cdo lëvizje rreth një drejtuesi specifik dhe doktrine specifike. Selia e lëvizjes Mouride në Toubë Senegal u themelua nga Amadou Bamba në 1883. Amadou Bamba (1850-1927) ishte një Mysliman mistik, një marabut (shkollar dhe mësues feje) dhe drejtues shpirtëror i cili dha udhëzime rreth meditimit, ritualeve Islamike, punës, dhe studimit të Kuranit. Forca e punës së tij ka prodhuar frute dhe dishpajt të tij janë të njohur për etikën në punën e tyre. Amadou Bamba nuk e mbështeti pushtimin Frances të Afrikës Perëndimore, por i rezistoi me luftë të shenjtë. Ai inkurajoi atë që quhet xhihad al-akbar “luftë e madhe” e cila duhet të lufohet përmes mësimit dhe frikës së Perëndisë. Vëllazëria Mouride në Senegal dhe Gambia kontrollon shumë sektorë të ekonomisë lokale. Ndjekësit shpesh dhurojnë pjesë të të ardhurave të tyre për lëvizjen. Abdoulaje Vade, Presidenti i tanishëm i Senegalit është një Mourid i përkushtuar. Menjëherë pas votimeve në 2000, Presidenti Vade udhëtoi drejt qytetit të shenjtë Touba për të kërkuar bekimin e drejtuesit shpirtëror të vëllazërisë (Grand Marabout).

Ide për lutje:

► *Drejtuesit Mouridë janë drejtuesit shpirtërore të 3 deri 5 milionë njerëzve dhe drejtuesit kryesorë të Toubës, qytetit Senegal i dyti nga madhësia (Popullsia 0.5 deri 1.5 milion). Lutu për drejtuesit Mouridë dhe ndjekësit të takojnë Perëndinë e gjallë. Barrierat ekonomike dhe sociale janë domethënëse (mund të luteni bazuar në Vep 13:4-12).*



Fokus: Lutja e së Premtes



Xhamia e madhe e Toubës, vëndi i varrit të Amadou Bamba. Ky është një nga qytetet më të rëndësishëm në të gjithë Afrikën Perëndimore.

Lutu për Myslimanët që do të mblidhen këtu sot për lutjet e zakonshme të së Premtes.

Malajzia

Malajzia është monarki kushtetucionale federale me qeveri parlamentare. Vendi është i ndarë në dy pjesë nga deti Jugor i Kinës, Malajzia Peninsulare dhe Malajzia Borneo. Me vëndodhje në zemër të Azisë Jug-lindore, Malajzia është e rrethuar nga vende të tjera si Tailanda, Indonezia, Singapori, Filipinet, Vietnami dhe Brunei. Kryeqyteti i Malajzisë është Kuala Lumpur.

Feja zyrtare e Malajzisë është Islami. Gjithsesi liria fetare është e garantuar në kushtetutë. Nga 28 Milion Malajzianë (Malajzianët, Kinezët dhe grupe të tjera etnike), 60.4 % e tyre janë Myslimanë. Malajzianët (grupi më i madh etnik) janë Myslimanë në përgjithësi. Ka edhe disa Myslimanë Indianë dhe një numër i vogël Kinezësh që janë konvertuar në Islam. Edhe pse Kryeministri i mëparshëm dhe ai i tanishëm kanë shpallur se vëndi është një komb Mysliman, segmente të dryshme e kanë kundërshtuar këtë qën-



drim duke ju drejtuar kushtetutes laike të vëndit. Proselitizmi (të konvertosh dikë në një mendim ose fe tjetër) është e ndaluar me ligj dhe konvertimi jashtë Islamit është e ndaluar.

Besimtarët me prejardhje Myslimane janë të pakët në numër. Shumë prej tyre adhurojnë në kisha shtëpiake dhe mbajnë traditën e veshjeve dhe zakonet kulturore. Në shumë raste ata e zbulojnë Mesian përmes një takimi hyjnor. Edhe pse ata janë të pakët në numër, janë të guximshëm në shpalljen dhe në besimin e tyre.

Ide për lutje:

- ▶ *Lutuni që besimtarët të hapin zemrat e tyre ndaj të fqinjve Myslimanë dhe të jenë bekim ndaj tyre në mënyrë praktike dhe konkrete.*
- ▶ *Lutuni që më shumë takime hyjnore të ndodhin mes Malajzinëve (shih Vep 10:17-48).*
- ▶ *Lutuni për besimtarët që të jenë plot kurajo ndërsa zgjatin dorën e miqësisë dhe ndihmës ndaj njerëzve të rinj (kjo mund të jetë e rrezikshme)*

Martirizuar në Arabinë Saudite



Në Gusht të 2008-ës, një klerik Mysliman dhe pjesëtar i Komisionit të promovimit të virtuteve dhe parandalimit të veseve në Arabinë Saudite, vrau motrën e tij 26 vjecare Fatime Al-Mutairi. Ajo i kishte shpallur besimin e saj familjes, në provincën lindore të Arabisë Saudite. Kontaktuesi nga ZIM “Zëri i Martirëve” raportoi se marrëdhënia e Fatimes me besimtarë të tjerë ishte e kufizuar në forumin e Internetit dhe korrespondencave telefonike. “Si pjesë e dëshmisë nga familjarët, ajo shpalli se rruga e Krishtit është rruga më e pastër dhe më e shenjtë nga të gjitha. Pasi e ndau këtë me familjen, ajo gjeti të vëllain në dhomën e saj me laptopin hapur përpara tij. Kontaktuesi I ZIM tha se: laptopi i saj mbante shënime të udhëtimit frymor të cilat ai po i kërkonte për më shumë fakte kundër saj. I vëllai e mbylli në dhomën e saj për katër orë, gjatë së cilës ajo pati mundësi të shkruante letrën e fundit në Internet. Shumë shpejt pas kësaj Fatimja u vra.

Kjo histori është marrë nga faqja e Internetit të “Zëri i Martirëve” ZIM Ju mund të gjeni më shumë dëshmi të besimtarëve që vuajnë. Në faqen e ZIM tek: www.persecution.com

Myslimanët në Moskë

Një dallgë nga Azia Qëndrore

Unë do t'i kryej veprat e atij që më ka dërguar sa është ditë; vjen nata kur askush nuk mund të veprojë. Gjon 9:4

Rusia është e njohur për historinë e saj të pasur, këmbënguljen e popullit përmes vështirësive, dhe kryeveprat arkitekturore. Pikturat solemne të ikonave, stepat e madha, pyjet me dëborë, ose gotat e çajit ngjyrë rozë, supra e borshtit mund të të vijë në mendje kur mendon për Rusinë. Gjithsesi fytyra e Rusisë është duke ndryshuar me shpejtësi. Moska, Kryeqyteti i Rusisë ka popullsinë më të madhe të Myslimanëve se çdo qytet tjetër në Europë. Vlerësimet variojnë nga 400.000 deri 2-3 milion Myslimanë (ndoshta vetë numri i të huajve të paligjshëm shkon në qindra e mijëra).

Shumë prej Myslimanëve të Moskës vijnë nga të varfërat, ish-republikat Sovjetike të Azisë Qëndrore. Taxhikët, Yzbekët, Afganët, Kazakët, Tatarët, dhe shumë të tjerë po vijnë në numra rekord, në kërkim të çdo lloj pune. Ata shpesh jetojnë së bashku në lagje me kushte të ngushta dhe të pista, duke kursyer sa më shumë që munden për të dërguar në shtëpitë tyre. Ata përballen me rrahje, vrasje, madje edhe shpërthime, dhe shumë prej tyre janë skllëvërit e ditëve-moderne, të frikësuar, nga punëdhënësit e tyre të ashpër. Jeta në Moskë nuk



është e lehtë, por ndonjëherë është shumë më e mirë se perspektivat e zymta në vendet e tyre.

Duke qenë larg nga vendi i tyre, traditat familjare, familja dhe presioni kulturor paraqesin tundime të reja për Myslimanët e Azisë Qëndrore, por edhe një mundësi të re për të dëgjuar të vërtetën e Fjalës së Perëndisë. “Unë e urreja Rusinë dhe nuk doja të kthehesha përsëri” tha një besimtar me prejardhje Myslimane. Pasi pa mundësinë për të arritur Myslimanët e vendit të tij, ai u ngazëllye rreth potencialit për një shërbesë. “Tani ndjehem sikur Rusia është vendi im i dytë,” thotë ai.

Edhe pse filmi i Jezusit, DVD e Maria Magdalenës dhe Bibla SHRAQ (Shkrimet Ruse të Azisë Qëndrore) pranohen mirë, ka vetëm një numër të vogël besimtarësh që specifikisht po arrijnë Myslimanët. Duke qenë se Myslimanët në Moskë shpeshherë janë emigrantë, janë të tronditur nga jeta në një qytet kaq të madh, malli për familjet dhe nga të kërkuarit për miqësinë. Është një moment i mirë t’ju shpallim Ungjillin atyre.

Ide për lutje:

- ▶ *Kërkojini Perëndisë të hapë zemrat e Myslimanëve në Rusi.*
- ▶ *Lutuni për përkthimin dhe shtypjen me cilësi të literaturës së Krishterë për Myslimanët Rusisht-folës dhe që besimtarët e rinj të mësojnë të ecin me Mesinë.*
- ▶ *Lutuni për vizion, unitet dhe urtësi për udhëheqësit në të gjithë Rusinë për t’u çuar Ungjillin Myslimanëve në Rusi - duke bërë dishepuj prej tyre në mënyrë të tillë që ata janë të inkurajuar, të aktivizuar dhe të pajisur për të bërë të njëjtën gjë.*
- ▶ *Lutuni për hapa konkrete dhe praktike nga kishat Ruse për të arritur Myslimanët rreth tyre.*
- ▶ *Lutuni për dishepullizimin e besimtarëve të rinj. Ka vetëm disa bashkësi për ata që vijnë tek Mesia, shumica janë vetëm Kazakë.*

Taxhikistan

Cfarë mban të fshehur e ardhmja?

Zebo është 18 vjeç dhe dëshiron të ndjekë universitetin. Ajo ëndërron për një jetë më të lehtë për familjen e saj në Taxhikistan. Ajo dëshiron të çlirohet nga shqetësimi për bukën e përditshme, si dhe nga borxhet apo ryshfetet e nevojshme për të marrë edukimin që dëshiron. Si shumë të rinj të tjerë, ajo beson që nëse thjesht mëson Anglisht dhe gjen një punë të mirë në një organizatë të huaj, do mund të sigurojë për veten dhe familjen e saj. Ajo ka pak shpresë te vendi i saj, ndryshe nga besimi i kaluar tek qeveria gjatë sistemit sovjetik. Madje Zevo vë në pikëpyetje edhe besimin e fortë, që familja e saj ka tek Islamizmi. Ajo e di që do jetë e vështirë të marrë nga jeta ato çka dëshiron. Prindërit e saj, kohët e fundit, i kanë bërë presion që të martohet, në vend që të ndjekë edukimin apo karrierën. Jeta duket si një rrugë pa krye. Ajo pyet veten, "Ku mund të gjej shpresë?"

Zebo përfaqëson mijëra të rinj e të reja që jetojnë pa shpresë për të ardhmen, në atdheun e tyre në Taxhikistan. I izoluar ndërmjet Afganistanit, Uzbekistanit, Kirgistanit dhe Kinës, ky vend me shtatë milion banorë, është republika më e varfër Ish-sovjetike. Mbi 80 përqind e popullsisë jeton nën nivelin e varfërisë dhe të ardhurat mesatare vjetore janë rreth 250 Euro për person. Gratë dhe fëmijët përbëjnë shumicën e popullsisë,

pasi shumë burra kanë shkuar në Rusi për të kërkuar punë. Disa prej tyre nuk kthehen më kurrë dhe as nuk i dërgojnë familjeve mbështetjen financiare të premtuar.

Në vitet e fundit, Islamizmi ka rritur influencën tek njerëzit, ngaqë disa prej tyre kanë studiuar në vende Myslimane më konservative dhe kanë sjellë me vete mësimet e tyre strikte. Nëntëdhjetë përqind e njerëzve në Taxhikistan, janë Myslimanë dhe vetëm 0.1 përqind besojnë tek Mesia. Ndërkohë që shumë janë të zhgënjyer nga Islami, disa prej tyre njëkohësisht janë duke kërkuar Perëndinë me sinqeritet.

Ide për lutje:

- ▶ *Ndërkohë që të rinjtë mendojnë për të ardhmen e tyre, le të gjejnë qëllimin e tyre hyjnor në Jezusin, Mesinë. Lutuni për më shumë punëtorë në të korrat mes të rinjve.*
- ▶ *Mungesa e baballarëve që punojnë në Rusi dhe gjetkë po jep impakt në themelet e shoqërisë Taxhike (Fjalët e Urta 1:8, 3:12, 4:1, Efesianëve 6:4, Psalmet 68:5, 27:10).*
- ▶ *Lutuni që të pregatiten dishepuj të fortë, të aftë të drejtojnë të tjerë në familjen e besimit. Shumë prej tyre janë besimtarë të rinj (1.Gjonit 2:12-14, Titi 2:1-14).*



Qyteti i vogël i Khorugh (ndoshta 20.000 banorë) dhe qytetet apo fshatrat e provincës autonome të Gorno-Badakhshan-it në Taxhikistan, janë disa nga vendet më të izoluara në botë. E ndodhur në malet Pamir, kjo provincë përbën 45 përqind të sipërfaqes së vendit por vetëm 3 përqind të popullsisë së tij (rreth 200.000 banorë). Shih Khorugh në Wikipedia.

Jezusi foli për shpalljen e Ungjillit deri "në fund të botës". Khorugh sigurisht që kualifikohet për këtë emërtim.

Arabët Shuwa në Çad

1.5 milionë njerëz që nuk e njobin Bariun e Madh

Arabët Shuwa emigruan nga Sudani drejt Çadit, qindra vite më parë. Gjuha e tyre është e ngjashme me Arabishten e Kuranit. Islamizmi është thelbësor në identitetin e tyre, madje ata e konsiderojnë veten si mbrojtës të besimit. Duke qenë shumë dyshues ndaj të huajve, ata janë shumë të frikësuar nga “syri i keq”, influencimi i demonëve dhe magjisë së zezë nga njerëzit përreth tyre. Nëse gjithsesi fiton besimin e tyre, mikpritja është e bollshme për personat e huaj.

Shuwa-t janë gjysmë-nomadë. Jeta e tyre është e fokusuar tek mirëqenia e kafshëve (lopë, dhi dhe dele). Në varësi të zonës ku ndodhen, gjatë stinës së thatë, familjet e reja lëvizin në kërkim të ushqimit dhe ujit për kafshët. Në stinën e reshjeve ata kthehen për të mirëmbajtur fushat e melit dhe misrit. Në përgjithësi ata jetojnë në komunitete të vogla, ku kryesisht përfshihet farefisi i tyre. Kur shteron uji dhe kafshët nuk mund të ushqehen më në atë vend, ose nëse fshati është bërë shumë i madh, një grup thjesht do të endet dhe do të vendoset në një zonë të re, të pabanuar. Disa familje të tjera po shkojnë drejt qyteteve, ku po bëhen tregëtarë të suksesshëm, duke adoptuar sjelljet urbane.

Në vitet e fundit nëpër fshatra janë hapur shkolla fillore, megjithëse vizitohen nga shumë pak fëmijë. Disa

nga vajzat bëjnë rrethprerje rreth moshës 6-8 vjeçare. Shpesh vajzat martohen me mblesëri me kushërinjtë e tyre, rreth moshës 12-14 vjeçare dhe zakonisht bëhen nëna në moshën 15 vjeçare. Shumë gra kanë rreth 8 deri në 10 fëmijë edhe pse vetëm 2/3 e tyre mbijetojnë. Djemtë e nisin shkollën islamike në moshën gjashtë vjeçare. Këto shkolla gjenden shpesh në zonat e fiseve të tjera, kështu që djemtë rriten të vetëm, në mungesë të prindërve, vëllezërve apo motrave. Atyre i duhet të kërkojnë lëmoshë për t'u ushqyer dhe u duhet të mbledhin para për mësuesit. Disa prej tyre akuzohen si hajdutë dhe rrihen.



Ide për lutje:

► *Shpallni në lutje të vërtetën nga Gjoni 10:10-16 në lidhje me këta njerëz nomadë dhe barinj. Shihni gjithashtu 1. Pjetrit 2:24-25.*

► *Shuwa-t duket që kanë respekt për të Krishterët që praktikojnë realisht besimin e tyre. Shpeshherë janë dërguar specialistë të ndryshëm në këtë zonë. Disa prej tyre edhe pse deklarorin që ishin besimtarë, për fat të keq, jo gjithmonë e nderonin Perëndinë me sjelljen e tyre. Lutuni që ata pak besimtarë që jetojnë në atë zonë, të jenë dëshmitarë të vërtetë të Mesias. Urojmë që ata të jetojnë një jetë realisht të denjë për Perëndinë. (Kolosianëve 1:9-12)*

► *Nuk dihet të ketë të Krishterë mes këtyre Arabëve. Pak individë kanë kërkuar Bibla apo kaseta. Filmi “Jezus” është i përshtatshëm për të bërë të njohur Ungjillin ndër këta njerëz.*

Lëvizja për kthimin në Jeruzalem

Besimtarët Kinezë duan të nderojnë Mesian e tyre

Histori: Në vitin 1940 Perëndia i foli besimtarëve të ndryshëm në Kinë mbi përhapjen e Ungjillit, duke filluar nga provinca Xinjiang në Kinën perëndimore, përmes vendeve Myslimane, deri në Jeruzalem. Ata e quajtën veten banda e Ungjillit “Prediko Kudo”; Misionarët perëndimorë i quajtën banda Ungjillore “Kthim në Jeruzalem”. Disa nga rrënjët frymërore të kësaj lëvizjeje mund të gjenden tek grupimi “Familja e Jezusit”, i cila në vitin 1920 shënjestroi disa fshatra dhe predikoi Ungjillin atje. Ata përkushtuan veten e tyre drejt “sakrificës, braktisjes, varfërisë, vuajtjeve dhe vdekjes”, për qëllimin e Ungjillit. Prioriteti i parë i lëvizjes “Kthim në Jeruzalem” ishte arritja e provincave në vijim: Xinjiang, Mongolia e brendshme, Tibeti, Sichuan, Qinghai, Gansu dhe Ningxia në Kinën qëndrore, veriore dhe perëndimore. Gjithashtu përfshinë si destinacione vendet kufitare në Azi: Afganistan, Iran, Arabi, Irak, Siri, Turqi dhe Palestinë. Duke arritur këto vende, ata dëshironin të krijonin grupe të rinj besimtarësh ndërkohë që kujdeseshin dhe rizgonin përpjekjet e mëparshme. Ata vendosën ti besonin totalisht Perëndisë për financat dhe përpjekjet e tyre. Lëvizja arriti në Kinën perëndimore gjatë vitit 1950, ku përjetoi persekutim të madh dhe shumica e besimtarëve u futën në burg. Simon Zhao, një nga drejtuesit e parë, u dënua me 31 vjet

burgim. Ndonëse Zhao hyri në burg si një i ri vizionar, ai doli nga burgu, në një Kinë krejt tjetër, si një burrë i moshuar, plot thinja dhe pa shokë. Lajmi për daljen nga burgu të Zhao u përhap, por vetëm pasi kaluan gjashtë vjet, drejtuesit e kishave u kujtuan për të.

Fillimisht Zhao nuk e ndau me të tjerët vizionin e tij për lëvizjen “Kthim në Jeruzalem”. Ai u përqendrua te inkurajimi i drejtuesve të Krishterë kinezë dhe tek lutja. Vetëm pas vitit 1990, Zhao filloi të ndajë vizionin e tij me një grup të Krishterësh kinezë, duke i nxitur ata të marrin mbi shpatulla vizionin që Perëndia i kish dhënë atij më shumë se 50 vjet më parë. Ai vdiq në vitin 2001, pas 15 viteve të tjera në shërbesë. Gjatë kësaj kohe, besimtarë të ndryshëm morën mbi vete barrën për të rinisur lëvizjen “Kthim në Jeruzalem”

Sot shumë të Krishterë kinezë, ndjekin vizionin për të arritur Kinën perëndimore dhe vendet Myslimane përgjatë rrugës drejt Jeruzalemit. Ata besojnë që në ditët e fundit para se të kthehet Krishti, do jetë detyra e kishës Kineze të rikthejë Ungjillin në Jeruzalem me qëllim që të mbyllet qarku i plotë i Ungjillit, që fillimisht erdhi tek ata nga Perëndimi.

“Qindra familje Kineze dëshirojnë të transferohen drejt zonave të paarritura të Kinës”, raportoi një drejtues

耶穌基督

Lart: Jezus Krishti në kinezë



i një kisha shtëpiake Kineze. Disa drejtues shpresojnë të dërgojnë mijëra misionarë rrugëtues për të arritur minoritetin etnik “jo-Han” dhe për të mbjellë kisha të reja. Shërbesa ndërkulturore është akoma një fenomen i ri në Kinë, prandaj disa besimtarë po luten vazhdimisht mbi rolin e tyre në arritjen e kombeve Myslimane, hinduiste dhe budiste, me lajmin e mirë të Mbretërisë.

Ide për lutje:

- ▶ *Adhuronit Zotin, shpallni në lutje të vërtetën nga Isaia 66:18-23. Perëndia hapte dyert për shumë Kinezë, që të shpallin lavdinë e Tij mes kombeve.*
- ▶ *Disa besimtarë Kinezë kanë hedhur tashmë hapa të guximshëm për të shpallur besimin e tyre në kultura të ndryshme, por rezultatet nuk kanë qenë pozitive. Egziston një nevojë e madhe për trajnime efektive dhe të thella, përtej kulturave të ndryshme, për ata persona që duan të çojnë Ungjillin tek njerëzit e tjerë. Trajnimi ka prioritet të madh. Vetëm zelli nuk mjafton.*

Stamboll, Turqi

Një qytet me 12.8 milion banorë, shumica e të cilëve, të paktën në emër, janë Myslimanë.

Stambolli dëshiron që njerëzit ta duan. Dhe ta duash atë, zakonisht është e lehtë. Ekstremisht i ndryshëm, qendrat tregëtare janë ndër më modernet në Evropë ndërsa disa rrugë në kalldrëm na kthejnë pas në kohën bizantine. Të rinj me trupat plot “piercing” përzihen lehtësisht nëpër rrugë me gra të mbuluara nga koka tek këmbët. Pajtimi i fesë me modernizimin është pjesë e makiazhit multikulturor të Stambollit, qytetit të pestë më të madh në botë, por i vetmi qytet në botë që shtrihet në dy kontinente. Rreth 3000 xhami ndodhen në Stamboll, por përqindja banorëve që janë besimtarë të përkushtuar varion ndryshëm. Afërsisht 70% e popullsisë jetojnë në pjesën evropiane të Stambollit ndërsa 30% në pjesën aziatike. Stambolli me të vërtetë është një qytet i botëkuptimeve të ndryshme.

Është mirë të kemi disa gjëra në mendje, ndërsa lute mi për Stambollin. Së pari, kultura është lindore; është e bazuar në konceptet e nderit dhe të turpmit më tepër se te konceptet e fajit dhe pafajësisë. Në marrëdhënie dhe besim, banorët e Stambollit përpigën të ruajnë dinjtetin. Kjo është një arsye përse familjet shpeshherë i largojnë anëtarët që i përkushtohen Mesias. Nderi i familjes nuk e lejon këtë gjë. Myslimanëve nuk i lejohet të braktisin Islamin. Ta bësh këtë është e turpshme për individët dhe familjet e tyre. Jezusi foli për braktisjen e gjithçkaje për

hir të Tij. Me siguri “braktisja e gjithçkaje” për hir të Tij është një zgjedhje reale për shumë të rinj në Stamboll. (Marku 10:29-30)

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i lutjes për Stambollin është çlirimi nga e kaluara. Megjithëse një pjesë e Stambollit është shoqëri laike, praktikat strikte islame, folklori islam dhe animizmi përbëjnë një pjesë të rëndësishme të jetës së përditshme për shumë njerëz. Gratë vendosin ruaua blu për të shmangur mallkimin dhe për të nxjerrur pjellorinë. Martesa dhe vdekja kanë zakonet e tyre të bazuara në vargjet e Kuranit. Çdo gjë i lihet në dorë fatit qiellor (i quajtur kismet), çka shkakton një përzjerje të frikës me inatin gjatë përbaljes me fatkeqësitë e jetës. Frika dhe irritimi janë pasoja të natyrshme të idesë islamike për Perëndinë e Abrahamit. Në këndvështrimin e tyre një person nuk mund të jetë i sigurtë për faljen e mëkateve apo çlirimin nga turpi. Për shkak të përzjerjes së këtyre besimeve, shumë besimtarë në Stamboll dëshmojnë për vështirësinë e shpjegimit të faktit që Jezusi, me dëshirë, dha jetën e tij për të na sjellë shpëtim. Besimtarë me të kaluar Myslimane, dëshmojnë për faktin që i duhet të bëjnë një ndarje të plotë me hajmalitë e tyre dhe botëkuptimet fataliste, për të qenë plotësisht të lirë për ti shërbyer Zotit. Lutja duhet të përmblajë rinovimin e atyre që gjejnë Krishtin (Efesianëve 4:22-24).



Ide për lutje:

- ▶ *Kur lutemi për Stambollin, le të përpiqemi ti shohim banorët e tij nga perspektiva e Perëndisë. Imagjinoni irritimin e njerëzve që punojnë shumë, shpesh deri gjashtëmbëdhjetë orë në ditë, por që rrojnë ja merr inflacioni.*
- ▶ *Lutuni për të rinjtë, për të cilët premtimet dhe shpresa për një të ardhme më të mirë, duken boshë.*
- ▶ *Lutuni për gratë që janë të destinuara të lindin djem dhe që shpeshherë braktisen nëse kjo nuk ndodh. Le të lutemi në besim që lutjet tona të dëgjohen. (Efesianëve 3:18, Gjoni 14:13, 2. Pjetri. 3:9)*

Mësoni më shumë për Stambollin: MeetIstanbul.com

Shih: Videon për Turqinë në YouTube, kanali “Prayershorts”



Nata e fuqisë

Sonte në xhamitë në të gjithë botën Myslimane mili-
Sona njerëz do të jenë duke u lutur për të kërkuar
ndihmën e Perëndisë. E ashtu quajtura “Nata e Fuqisë”
është një natë e veçantë. Myslimanët besojnë se Muha-
medi mori Kuranin gjatë pjesës së fundit të Ramazanit.
“Nata e Fuqisë” përkujton këtë ngjarje. Myslimanët do
të bëjnë aktivitete të ndryshme fetare gjatë kësaj natë,
por shumë i bëjnë kërkesa të veçanta Perëndisë. Disa
Myslimanë ngrihen herët për të bërë kërkesat e tyre, të
tjerët kalojnë shumicën e natës në lutje. Ata inkurajo-
hen të kërkojnë Allahun me singëritet dhe bindje për
çdo gjë që ata kanë nevojë e që është e lejueshme në
besimin e tyre.

Pa asnjë dyshim disa njerëz përreth botës do të kërkojnë
ndihmën e Perëndisë për çështje punësimi, martesë,
aftësinë për të pasur fëmijë e gjëra të tjera. Sidoqoftë,
Myslimanët në gjithë botën kanë nevojë për ndihmë për
kushërinjtë e tyre me të meta (invalidë). Shumë nga
rastet më të vështira mes të rinjve dhe të vjetërve e gjejnë
veten të papranuar, të fshehur, të braktisur dhe abuzuar.
Njolla (turpi) e tyre sociale është i madh sepse ata kon-
siderohen si “mallkimi i Perëndisë”. Familjet shpesh i
fshehin ata, i lidhin ata me paaftësi mendore në dhomat
e prapme ose i dergojnë larg në institucionet shtetërore.
Shumë institucione janë të mbipopulluara dhe të paaf-
ta për tu përkujdesur siç duhet për nevojtarët. Në një in-
stitucion të tillë në Turqi, është një listë pritëse prej 3000

Fokusi: Lutja e së Premtes

individësh. Prindër ose të afërm që nuk duan ose nuk
dinë se si të përkujdesen për fëmijët e tyre me paaftësi,
besojnë se qeveria do të bëjë një punë më të mirë për
tu përkujdesur për fëmijët e tyre. Rezultati është i
ngadalshëm, shpesh lëndohen deri në vdekje ose grum-
bulohen në streha me kushtet e një burgu. Ne mund të
lutemi për një “Natë të Fuqishme” të vërtetë në jetët e
shumë prej atyre që vuajnë nga dhimbja, nga mjerimi
dhe refuzimi për shkak të paaftësive dhe sëmundjeve.

Dëshmi: Murati në Turqi ishte një nga këta djemtë e
braktisur, i lënë nga i ati në pragun e derës së një jeti-
moreje kur ishte djal i vogël me paralizë celebrale. Unë
e takova atë 15 vjet më pas ndërsa jetonte në një krevat
fëmijësh psikikë shumë të vogël për të, në një pavion për
fëmijët e paaftë mendërisht dhe fizikisht. Pasi zbulova
se ai mund të fliste dhe nuk ishte i paaftë mendërisht,
i thashë atij se Perëndia e donte atë ndërsa u përballa
me përgjigjen e tij të qartë, “Jo Ai nuk më do. Fakti që
jam i paaftë do të thotë së përfundimisht Perëndia nuk
më do”. Murati më lejoi të lutesha me të atë ditë. Një
javë më vonë shkova ta takoja në krevatin e tij të vogël
për fëmije psikik, unë takova një djalosh të ndryshuar.
Zoti Jezus i ishte shfaqur atij dhe i kishte thënë se Ai e
donte. Murati po qeshte vesh me vesh “Unë e di Perën-
dia më do mua!” Ai qeshi me gëzim ndërsa unë po qaja
me mirënjohje të thellë për mesazhin e Mbretërisë. Kjo
“shenjë” ndoqi shpalljen e Mbretërisë së Perëndisë.



Ide për lutje:

*Ne sigurisht mund të lutemi për Njerëz në shumë kombe
sonte, Perëndia ju drejtoftë. Shumë kërkojnë Zotin gjithë
natën.*

*Këtu keni Një subjekt specifik : Rreth 1/6 e popullsisë së
Turqisë prej 73 milion lufton me disa forma sëmundjeje
dhe paaftësie. (Shiko Mt 15:30; Mark 1:34 dhe 3:10)*

► *Lutuni për besimtarët e mrekullueshëm Turq të cilët
po takojnë Njerëzit me Nevoja të veçanta. Qofshin ata
të forcur dhe të drejtuar Frymërisht drejt atyre të
parapërgatiturve.*

► *Lutuni për ndryshim social në lidhje me të sëmurët
mendërisht dhe të paaftët fizikisht. Lutu të rritet numri i
atyre që nuk flaken poshtë nga varfëria ose nga qëndrimi
poshtëruar social.*

► *Lutuni që një politikë e re qeverisëse të zbatohet në
Turqi, e cila do të lejojë vullnetarët të punojnë rregullisht
brenda këtyre institucioneve që kontrollohen nga shteti.*

► *Lutuni për një rritje të medias në komunikimin e Lajmit
të Mirë tek të paaftët.*

Batica ndryshuese në Azinë qendrore

Termi “Azia Qëndrore” shpesh i referohet 5 ish-Republikave Sovjetike të Kazakistanit, Kirgistanit, Uzbekistanit, Takhikistanit dhe Turkmenistanit. Sidoqoftë disa herë kufijtë e rajonit të ashtuquajtur Azia Qëndrore mund të shtrihen duke përfshirë vënde si Azerbajxhani, Afganistani, Irani, dhe rajoni autonom Xinjiang i Kinës Veriperëndimore. Rruga e lashtë e Mëndafshit, intinerari i famshëm tregtar që Marko Polo dhe të tjerë udhëtuan, kryqëzon rajonin nga Xian, Kinë, në Stamboll, Turqi. Edhe pse tani rajoni është i ndarë nga kufij kombëtar, shumica e grupeve etnike janë Turq, e kanë gjuhë dhe kulturë të njëjtë. Për shembull, Ujguret (në Kinën Veriperëndimore) Kazakët, Uzbekët, Kirgizët, Turkmenët, Azerët dhe Turqit të gjithë flasin gjuhë të bazuara tek Turqishtja. Sidoqoftë gjuha Takhik është me rrënjë Persike, e njëjtë me gjuhët e folura në Iran dhe Afganistan.

Pas rënies së Perdes së Hekurt, një derë e mrekulueshme u hap për Ungjillin në Azinë Qëndrore. Në 1990 ishin më pak se 2000 besimtarë midis popujve me mbizotërim Mysliman të rajonit. Sot është vlerësuar se janë mbi 80,000! Janë mbjellë shumë bashkësi dhe pastorë e drejtues janë ngritur. Këto asamble janë duke dërguar Njërezit e tyre në kombe të tjera si në Kinë, Turqi, Mongoli, Afganistan dhe Iran. Historia e mahnitshme

se çfarë ndodhi gjatë 15 viteve pasuese pas 1990 është një nga historitë më të mëdhaja të kohës sonë.

Megjithatë, dritarja e lirisë për Ungjillin në Azinë Qendrore ishte jetëshkurtër. Turkmenistani ishte vendi i parë që dëboj “punëtorët” të huajt, dhe u ndoq nga Uzbekistani. Rregjistrimi i Kishës u bë i vështirë, apo i pamundur për tu bërë. Kufizime të tjera u bënë ligj në Takhikistan dhe Kirgistan. Edhe Kazakistan, i cili ka qenë i njohur si me i hapuri nga vëndet e Azisë Qëndrore, është duke planifikuar një ligj në 2011 i cili imponon kufizime më të mëdha mbi besimtarët. Ndjekësit e Jezusit në shumë zona tani rrezikojnë të arrestohen, të pyeten dhe gjobiten kur ata takohen sëbashku. Pastorët janë akuzuar në mënyrë të rreme dhe janë dënuar me burg nga disa javë në disa vite.

Ide për lutje:

▶ *Lutuni për besimtarët e Azisë Qëndrore sipas Veprave të Apostujve 4:29-30, “Dhe tani, Zot, shqyrto kërcënimet e tyre dhe lejo që shërbëtorët e të kumtojnë fjalën tënde me plot çiltërsi, duke e shtrirë dorën tëndë për të shëruar dhe që të kryhen shenja dhe mrekulli në emër të Shërbëtorit tënd të shenjtë Jezusit”.*



Historia tregon që persekutimi dhe kufizimet e vendosura mbi besimtarët s'mund të ndalojnë Ungjillin të levizë përpara. Disa herë kufizimet, burgimet dhe madje edhe martirizimet kanë ushqyer flakët e ringjalljeve.



Turqit në Berlin

Disa herë Berlini është quajtur qyteti më i madh Turk jashtë Turqisë. Shumica e Turqve në Berlin mbajnë kombësinë e tyre Turke, ndërsa të tjerë janë bërë qytetarë neutral Gjerman. Që nga 2007 mijëra folës të tjerë Turq nga Bullgaria i janë shtuar përzjerjes. Për emigrantët nga Turqia, Bullgaria dhe kudo tjetër, jeta në Berlin do të thotë shokim i madh kulturor dhe ndryshimi. Për shumë kjo është hera e parë në një qytet të madh kaq shumë të ndryshëm nga fshati në vendin e tyre. Shpesh ëndërrat e tyre për sukses ekonomik dhe siguri mbeten të paarritura. Për shkak të krizës ekonomike botërore sot përqindja e të papunëve midis Turqëve në Berlin është rreth 40%.

Për dekada emigrantët Turq në Berlin janë vendosur në qytet. Një komunitet i tërë Myslimanësh Turk është formuar, kështu që edhe Turqit me pak njohuri të Gjermanishtes mund të mbijetojnë. Myslimanët në disa lagje dominojnë rrugët e qytetit, duke rritur kontrollin e tyre mbi individet. Për shembull, nëse një Turk viziton një banak librash të Krishterë dhe merr diçka, ai ka mundësi të ndalohej dhe ti flitet, pak metra më tutje nga një shikues Mysliman.

Edhe pse Turqit kanë jetuar më shumë se 40 vjet në një numër të madh në Berlin, shumë kisha nuk i kanë vënë re ata, por ka edhe përjashtime. Disa janë lutur



për mundësi për të arritur komunitetin Turk me Ungjillin. Shumë literatura janë dhënë përmes kontakteve personale dhe miqësive. Përgjatë vitëve, rreth 50 Turq në Berlin kanë njohur Mesian. Disa nga këta besimtarë takohen në bashkësi shtëpie ose mblidhen shpesh për shërbesa të folura në Turqisht. Tani afër një grup i ri është krijuar midis të krishterëve Turq nga Bullgaria.

Ide për lutje:

► *Lutuni për kontakte të afërta për besimtarët në Berlin me Turqit, në mënyrë që ata të mund mësojnë për dashurinë e Perëndisë dhe të dëgjojnë dëshmi të qarta se si Turqit kanë ardhur tek Jezusi.*

► *Lutuni për dashuri, autoritet, dhe dëshmi efektive të besimtarët që aktualisht kanë kontakte me Turqit. Besimtarë të motivuar janë veçanërisht të nevojshëm për të arritur brezin e dytë dhe të tretë të emigrantëve Turq.*

NDRYSHIME KULTURORE

Në Perëndim të rinjtë janë të lirë të veprojnë aq spontanisht sa ata duan, përsa kohë ata janë brenda kornizave të së drejtës dhe të gabuarës. Ata mund të jenë të zhurmshëm, të egër dhe të lumtur për aq kohë sa ata nuk thyejnë gjëra ose abuzojnë të tjerët. Rregulli në Perëndim është "për aq kohë sa ti nuk lëndon dikë tjetër ose pronat e tyre, ti je në përgjithësi në rregull."

Të rinjtë në një ambient Mysliman janë ndryshe. Kudo që shkojnë ata përfaqësojnë familjet dhe fiset e tyre. Të rinjtë nuk janë të lirë të veprojnë ashtu si ata duan. Ata duhet të veprojnë në mënyrë të nderueshme në mënyrë që nderi i familjes dhe fisit të tyre të ngrihet lart. Nëse ata dëmtojnë pronën e dikujt tjetër, është keq sepse sjell turp në popullin e tyre e jo sepse së pari ofendon viktimën. Nëse askush nuk e di se kush e bëri atëherë nuk ka turp, ose ndjenja fajësie. Ata ndihen fajtorë sepse sjellin turp tek Njerëzit e tyre, por jo sepse ofendojnë palën e tretë.

Nga një libër i Roland Müller, Mezazheri, Mesazhi dhe Komuniteti, Canbooks 2010, p.148 (Libri mund të blihet online).

KUSH JANË SHI'ASIT (SHI'ITET)?

Tre kalifët e parë (pasardhës) të Muhamedit u zgjodhën nga komuniteti i madh i Myslimanëve. I katërti ishte Ali, nipi i Muhamedit dhe dhëndri i cili ishte martuar me vajzën e Muhamedit, Fatimen shumë vite më parë. Ali ishte i aftë të mbante pozicionin e tij për pak kohë derisa të vritej në 661 pas Krishtit. Shi'a besojnë se sunduesit e duhur të gjithë komunitetit Mysliman botëror ishin Ali dhe 11 pasardhësit e tij përmes nipit të Muhamedit Husein, i cili vdiq si martir në Irak në 680 pas Krishtit. Shumica e Shi'as

besojnë se vija e pasardhësve të Huseinit vazhdoi derisa pasardhësi i tij Mohammed al-Mahdi, i 12 nga "Imam i udhëzuar në drejtësi" u zhduk në mënyrë misterioze në fillim të 874 pas Krishtit në moshën 5 vjeçare. Ai mesa duket ishte i arritshëm nga njerëz të veçantë deri në 941 pas Krishtit. Pas kësaj shpresa e Shi'a për të sunduar iu transferua totalisht botës së padukshme prej së cilës një udhëzues shpirtëror i fshehur – i quajtur Imam i Fshehur (drejtues) ose Mahdi (ai që udhëzon), do të kthehet përfundimisht.

Dhembshuri

"Ai ndjeu dhembshuri për ta sepse ishin si dele pa bari ..." Mark 6:34. Afganët kanë qënë nëpër një seri lufrash të tmerrshme.



Qizilbash i Afganistanit

Gjuha: Dari Popullsia: 316,000

Emri Qizilbash, i cili është Turqisht, për "Kokat e Kuqe" i është dhënë një varieteti të gjere grupi militantesh Shi'a (Shi'ite), i cili ka ndihmuar për të themeluar Dinastinë Safavid të Iranit (1501-1722). Emri i tyre ka rrjedhur nga kapelet e tyre dalluese me 12 maja të cilat tregojnë besnikërinë e tyre ndaj degës së "Dymbëdhjetë" të Islamit, Shi'itë (grupi kryesor Shi'a). Qizilbash në Afganistan janë pasardhes të trupave që mbetën pas nga Nadir Shah gjatë "Fushatës së tij Indiane" në 1738. Ata mbanin poste të rëndësishme në zyrat qeverisëse në të shkuarën, dhe sot ata janë të angazhuar në tregti ose janë zanatçinj, zejtar. Si folës Persianë, Myslimanët Shi'a formojnë një element të rëndësishëm dhe influencues politik të shoqërisë në Afganistan. Shifrat ekzakt të popullsisë janë të vështirë për tu siguruar pasi ata kanë marrë një identitet të dyfishtë fetar (të quajtur taqiya) për shkak të persekutimit nga Muslimanët Suni. Nuk njihen besimtarë mes Qizilbasheve.

Ide për lutje:

- ▶ Adhuroni Zotin me këngë. Shpallni sovranitetin e Jezusit deri në skajet e tokës duke përdorur Psalm 72:5-8, 12-14 (Mendoni për varfërinë dhe dhunën në Afganistan).
- ▶ Lutuni për dyer të hapura në jetën e Qizilbasheve në mënyrë që besimtarët të mund të gjejnë mundësitë për të ndarë Jezusin me ta.
- ▶ Lutuni për punëtorë midis besimtarëve Afganë që tu shërbejnë Qizilbasheve.
- ▶ Ka shumë pak burime Ungjillore në gjuhën e tyre. Lutjuni Perëndisë që të ngrejë gjuhëtarë të përkthejnë Shkrimet, literaturë dhe incizime audio në Dari. (Informacion nga Frontierët)

Lëvizja e Tablihi Xhematit

Grupi misional më i madh Islamik



Në vitet e fundit tre deri pesë milionë Myslimanë kanë përshkuar rrugën deri në Tongi, në veri të Dhakës, ku qeveria e Bangladeshit ka veçuar 160 akër (0.65km2) veçanërisht për këtë ngjarje të përvitshme. Ata vijnë nga 80 vende, për tre ditë “Ijtema” që do të thotë “të mbledhurit së bashku”.

Pas Haxhit ky është vendi më i madh mbarëkombëtar i mbledhjeve për Myslimanët. “Bishva Ijtema” (takimi global) sponsorizohet nga lëvizja Tablihi Xhemati (shoqëria e përhapjes së besimit).

Kjo mbledhje fokusohet në lutjet dhe meditimin. “diskutimet politike nuk lejohen në këtë takim” pohon Tablihi Xhemati. Zakonisht i rreferohen thjesht me TXh, Tablihi Xhemati është misioni më i madh mbarëbotëror (në Afrikë, Amerikën e Veriut, Evropë, Azi e tjetërkund). Nuk ka një shumë egzakte për ndjekësit e TXh, por vlerësimet thonë rreth 70 deri 80 milion njerëz duke e bërë levizjen më të madhe brenda Islamit.

Tablihi Xhemati fokuson vëmendjen në “korrigjimin” e praktikave dhe doktrinës Myslimane. Pjesë e kësaj është edhe veçimi ndaj jo Myslimaneve. “Ne ju themi vëllezerve dhe motrave që jetojnë në shoqëri laike se përzierja me jo Myslimanë do t’i bëjë ata Myslimanë

më të dobët,” thotë Naim, një zëdhënës në Kanada. “Ne ju themi të veçohen, të ndërtojnë shkollat e tyre dhe të shpenzojnë kohën me Myslimanët e tjerë. Kjo është e vetmja mënyrë për të luftuar forcën e sekularizmit”.

TXh janë bërë shumë të suksesshem, pjesërisht sepse një nga gjashtë “Hapat” e tyre kërkon që ndjekësit të shkojnë në grupe për disa ditë ose javë në të njëjtën kohë për të rinovuar besimin e tyre. Ata janë gjithashtu të përfshirë duke folur me Myslimanë të tjerë të rritin praktikatat fetare. Ata janë të kritikuar nga disa grupe Islamike si një sekt i veçuar, “mësimet e të cilit veçojnë të gjithë Myslimanët e tjerë që nuk bëjnë atë që thotë përkufizimi i tyre i veçantë mbi përcjelljen e mesazhit Islamik”.

TXh janë vetë shpallur pacifistë, të cilët kujdesen për të qëndruar larg internetit dhe kamerave. Por mesazhi i tyre ka qënë i suksesshëm në vëndë si Bangladesh, ku shkatërimet natyrore kanë detyruar dhjetra mijëra drejt kampeve refugjate. “Ata janë të vetmit që po ndihmojnë njerëzit” thotë Anvar. “Qeveria nuk ka bërë asnjë gjë, por grupet fetare kanë qënë atje që nga fillimi. Ata po i fitojnë njerëzit lokalë.”

**“Bishva Ijtema” foto nga blogu:
dhakadailyphoto.blogspot.com**

**(Nje faqe shumë e mirë dhe ndërtuese për të parë
dhe kuptuar jetën në Bangladesh)**

Ide për lutje:

► **Ndërsa pjesëtarët e TXh-së levizin nëpër botë, lutuni që ata do të takojnë të Krishterë të cilët do të reflektojnë jetën dhe dashurinë e Mesias ndaj tyre. (Kol. 4:3, Ps 9:20)**

► **Lutuni për Bangladeshin, një vënd që është rreth 85% Mysliman dhe i cili vuan më shumë se pjesën më të madh të botës. Mbi popullimi serioz, përhapja e gjërë e varfërisë, dhe katastrofat, përfshirë këtu përmytjet, ciklonet dhe uria që kanë prekur fort vëndin. Perëndia është duke hapur zemrat e Myslimanëve ti përgjigjen Ungjillit (Shih Vep 16:13-14).**

► **Lutuni që bashkësi të forta të themelohen ndërsa Perëndia po punon në këtë komb. Është i nevojshëm dishepullizimi i orientuar drejt kryqit për ata që janë të interesuar.**

Islami, Shariati dhe Globalizimi

Këto ditë ka një konfuzion të madh në qarqet e Krishtera rreth Islamit. Nga një anë, dëshmitë e të Krishterëve të persekutuuar, dhunuar dhe diskriminuar vazhdojnë në vendet si Pakistan, Arabi Saudite, Iran e vende të tjera. Levizja për të ndaluar mbulimin e plotë të fytyrës (niqab) në disa vënde të Evropës gjithashtu bashkon gabimisht versionin e ligjit Islamik (Shariatit) me Islamin dhe Myslimanët në përgjithësi. Nga ana tjetër slogani “Islami është një fe paqësore” shfaqet në median laike bashkangjitur me raportimet e kompleteve terroriste të al-Kaedës dhe bashkëpunëtorëve të saj. Ku është e vërteta?

E vërteta është, historia Islamike shfaq më shumë kompleksitet se sa shumë Myslimanë vetë mund të kuptojnë. Ligji Islamik i cili u shfaq gradualisht vetëm në shekullin e tretë pas vdekjes së Muhamedit, u zhvillua

Shumë Myslimanë kanë internalizuar ideat e të drejtave të njeriut dhe demokracisë. Por gjithashtu në të njëjtën kohë ata janë bërë më shumë fetarë dhe konservativë

me kohën nga të paktën gjashtë shkolla, me një mosmarrëveshje domethënëse mes tyre. Kjo ishte “Jurisprudenca e aplikuar” (ose “fiqh”), me termin “Sharia” zakonisht i rreferohet projektit ideal të Perëndisë për shoqërinë njerëzore siç është marrë nga Kurani dhe Shëmbulli (Suna) i Profetit. Shumë pak tekste flasin për atë që ne mund ta quajmë sot “ligji kushtetues”. Në praktikë nga kalifatet të hershme deri në mbretëritë e vogla që u ngritën në skajet e perandorisë deri në perandorinë e fundit madhështore Otomane, historia e shoqërisë Myslimane mund të përmlihet në luftën mes specialistëve ligjorë (ulama) dhe sunduesve politikane. Në të shumtën e kohës ata kanë pasur mosmarrëveshje.

Sot kombet Myslimane janë të gjitha shtete moderne, nënshkruese të konventës së OKB-së që tani konsiderohet si “ligj ndërkombëtar.” Shumica e tyre janë autoritare. Gjithsesi sipas referimit të Gallup Poll-it e llogaritur mes 2001-it dhe 2007-ës të 35 vendeve Myslimane, pjesa më e madhe e Myslimanëve e konsideronin Islamimin dhe demokracinë, barazinë gjinore dhe lirinë e fjalës si celësat për një shoqëri në paqe dhe të begatë. Ata nuk janë dakort me mënyrën se si këto vlera janë modeluar në Perëndim; ata preferojnë ti aplikojnë ato sipas traditës së tyre.



Globalizimi—rrjedhja e vrullshme e mallrave, kapitali, emigrimi dhe informacioni nga të gjitha drejtimet kanë ndikuar thellë jo vetëm shoqëritë Myslimane por edhe ato Perëndimore. Studimet sociologjike i bëjnë kronikën fenomenit të përhapjes së rizgimit fetar dhe se si globalizimi ka “çteritorjalizuar” traditën fetare. Për Myslimanët në vecanti, përmes internetit dhe rritjes së emigracionit kjo do të thotë rishikimi i traditave Islamike në disa drejtime. Qartësisht shumë Myslimanë kanë ndërkomëtarizuar ideat e të drejtave të njeriut dhe

Globalizimi ka ndikuar thellësisht shoqëritë Muslimane...

demokracisë. Por gjithashtu në të njëjtën kohë ata janë bërë më shumë fetarë dhe konservativë, vecanërisht në fushën e modestisë për gruan. Por për disa heqja e shenjave të kulturës së vjetër ka rezultuar në një fetarizëm me fokus mbi çfarë është dhe çfarë nuk është “Islami”. Kështu ekziston një minoritet i vogël por i zhurmshëm (Salafis) të cilët edhe në Perëndim luftojnë për “apazhdon ...



Duke ndihmuar Myslimanët të zbulojnë ...

likimin e plotë të Shariatit” Këtu “Shariati do të thotë marrëveshja mesjetare e shkollave ligjore mbi statusin e familjes, hududë (pesë dënimet, si prerja e duarve për hajdutët dhe vdekja për “femohuesit”) dhe të tjera si këto, varen nga grupimet e veçuara. “Xihadi” është një nga këto grupe.

Për të qënë i drejtë, gjithsesi, është e gabuar të shikosh të gjithë Myslimanët si “ekstremistë” kur shumica e tyre janë duke bashkëpunuar me pjesën tjetër të shoqërisë civile globale për të arritur më shumë paqe dhe mirëkuptim midis njerëzve të botës sonë. Si të Krishterë ne thjesht duhet të jemi miq ndaj fqinjve tanë Myslimanë, të dëgjojmë dhe të mësojmë prej tyre, dhe të ndajmë dashurinë e Shpëtimtarit përmes fjalëve dhe veprave.



Është e mundur të ndihmohet Myslimanët të zbulojnë Mesianin e gjallë. Te flasësh me Myslimanët për Zotin duhet të marrësh parasysh kontekstin e kulturës dhe fesë Myslimane. Në këtë mënyrë diskutimi ynë me Myslimanët do të jetë i ndryshëm nga ai me njerëz të tjerë. Mesazhi është i njëjtë, mënyrat për ta bërë atë të njohur janë të ndryshme.



Messian e gjallë

Parime të Përgjithshme

1. Lutu!!!: Ne nuk mund të theksojmë mjaftueshëm varësinë tonë ndaj ndërhyrjes së Frymës së Shenjtë.

2. Mbaj një qëllim specifik: Perëndia dëshiron të na përdorë për t'jua bërë të njohur Mesianin Myslimanëve përmes Ungjillit.

3. Ji i hapur ndaj kontakteve personale dhe njerëzore: Ne duhet ti duam Myslimanët me sinqeritet, duke manifestuar dashurinë tonë përmes mirësisë dhe respektit në marrëdhënien tonë me ta. Ashtu si në çdo marrëdhënie të vërtetë ne duhet të marrim kohë për t'i kuptuar, vlerësuar dhe për t'i ndihmuar miqtë tanë Myslimanë. Ne duhet të kemi dëshirën për të mësuar prej tyre dhe të zhvillojmë një shkëmbim të sinqertë miqësie plot kënaqësi.

4. Jini të durueshëm: Ndërsa ne flasim hapur për besimin tonë që nga fillimi i miqësisë tonë me një Mysliman, duhet të kemi ndërmend që shumica e Myslimanëve kanë nevojë të dëgjojnë sa më shumë që është e mundur përpara se të fillojnë ta konsiderojnë të besuarit në Mesia. Mos u dekurajoni nga kundërshtimet. Kujtoni që është mirësia e Perëndisë e cila na drejton në pendim. (Rom 2:4).

5. Shpjego Ungjillin në një mënyrë shumë të thjeshtë: Përdor fjalë dhe terma që do të jenë të kuptueshëm për Myslimanët. Shpjego kuptimin tënd ndaj termave si mëkati, lutja, Perëndia, Mesia dhe besimi. Shpesh këto terma mbartin një kuptim tjetër për Myslimanët.

Respekt Mirësi Butësi

Këto cilësi janë të domosdoshme për të arritur një Mysliman me mesazhin e Mesias.



Djathtas: Gra Myslimane afër urës Golden Gate, pranë San Francisco në Kaliforni.



6. Jepi mikut tënd një Testament të Ri ose një

Bibël: Inkurajo një lexim të rregullt të Ungjijve në veçanti.

7. Thekso shenjtërinë e përsosur të Perëndisë:

Thirrja e Perëndisë për drejtësi. Njeriu është përgjithësisht i pa drejtë dhe skllav ndaj sjelljes mëkatore. As edukimi e as mësimi i moralit nuk do ta ndryshonte këtë situatë. Njeriu ka nevojë të rilindë sërish.

8. Fol për ndërhyrjen e Perëndisë në jetën tonë:

Trego për besnikërinë, dashurinë dhe drejtësinë e Tij. Myslimanët nuk e kuptojnë Perëndinë si dikush që jep dhe mban premtime. Dëshmia jote plot besim e një Perëndie aktiv është shumë e rëndësishme.

9. Përgjigju kundërshtimeve me shumë mirësi:

Mos e lejo veten të rrëmbesh nga diskutime pasionante. Ne jemi thirrur të bëjmë miq për Jezusin jo të fitojmë argumenta.

10. Mos u bëj naiv nëse miku yt Mysliman shpreh një besim ndaj Jezus Krishtit dhe Biblës:

Nga një anë Myslimanët besojnë tek Jezusi dhe Bibla, gjithsesi besimi i tyre është i ndryshëm nga ajo që mëson Bibla. Ata besojnë se është e pa mundur të jesh në një marrëdhënie me Perëndinë ashtu sic besojmë ne. Jezusi tha se jeta e përjetshme është të njohësh Perëndinë (Gjon 17:3). Nuk është thjesht të njohësh disa gjëra rreth Perëndisë por ta njohësh atë personalisht. Myslimanët nuk besojnë se Mesia vdiq dhe u ngrit nga të vdekurit.

11. Prezantoi Myslimanët që janë duke kërkuar Mesian me një

bashkësi besimatarësh. Myslimanët ndonjëherë do të jenë më të interesuar për të parë bashkësinë e besimit se sa të dëgjojnë fjalët tona më të mira rreth Shpëtimtarit. Ndërsa ata shohin bashkësinë tonë, Perëndia na ndihmoftë të jemi ata që janë të dobët e të pa shpresë por të fortë në Ai. Ne të gjithë kemi nevojë për të tjerët. Është e drejtë të duash të tjerët. (1 Gjon 3:14-15) Myslimanët që vijjnë tek Mesia kanë nevojë për të tjerët.

12. Mbështetu tek Perëndia, i cili është i vërtetë për t'i afuar njerëzit tek realiteti.

Disa herë ne të gjithë kemi qënë ose jemi mashtruar. Ne kemi nevojë për qartësi dhe qllirim. Vetëm Perëndia mund të na japë ne dhe Myslimanëve sy për të parë dhe veshë për të dëgjuar.

Një mikpritje dashamirëse dhe e sinqertë mund të ndihmojë më shumë një Mysliman të zbulojë Mesian se sa shumë prova dhe argumenta llogjikë.

Duke Ndhimuar Myslimantët të zbulojnë Mesian...

Cfarë dubet të shmbangim?

• **Mos sulmo personin e Muhamedit.**

Ne jemi thirrur të ndihmojmë njerëzit të zbulojnë Jezusin, jo të kritikojmë të tjerët. Mesazhi ynë është Jezusi.

• **Mos e kritikoj Kur'anin.** Njerëz me njohuri të thellë rreth Kuranit, në mënyrë aktive dhe efektive flasin me Myslimanët rreth këtyre temave.

• **Shmang temat e ndjeshme-politike** si problemin i Palestinës ose të lavdërës Izraelin.

• **Të ngulësh këmbë duke thirrur Jezusin "Biri Perëndisë" mund të krijojë probleme në fillim:**

Shumë Myslimanë mendojnë se një besim i tillë nënkupton se Perëndia At kreu marrëdhënie seksuale me Marinë dhe ajo lindi një djalë. Shpjegimet janë të nevojshme. Për ide shiko faqet e rekomanduara të internetit.

• **Mos hyr në një diskutim rreth mishit të derrit dhe verës:** Ne si të Krishterë jemi dërguar të shpallim Jezusin e jo të vendosim ligjet e dietës. Është mirë të këmbëngulim se të dehurit është gabim. Mos ju servir alkohol Myslimanëve.

Udhëzime Specifike

1. Fillimisht fokusohu në fushat ku bini dakort: Në takimet e para me Myslimanët edhe më vonë është e nevojshme të bini dakort sa më shumë që të jetë e

mundur rreth gjerave të përbashkëta që besojmë. Ata besojnë se ka vetëm një Perëndi, Perëndia i Abrahamit. Në Arabisht fjala që përdoret për Perëndi, është "Allah" (Të Krishterët Arabe gjithashtu përdorin këtë fjalë për Perëndi). Myslimanët besojnë se Perëndia krijoi botën; Ai di gjithçka, Ai është i gjithdijshëm. Myslimanët nuk besojnë në Trinitet. Ata besojnë në engjëjt dhe në profetët si Abrahami, Moisiu, Davidi, Noe dhe Jezusi. Ata besojnë në gjykimin e fundit. Në përgjithësi ne mund të biem dakort në këto pika, pa harruar ndryshimet themelore. Duke pohuar besimet tona të përbashkëta ata do të ishin më të hapur të na dëgjonin me një kuptim më të gjërë. Por dikush nuk duhet vetem bjerë dakort.

2. Përdor histori: Trego Histori rreth jetës së Jezusit, burrave dhe grave të përmendur në Bibël. Shumë nga Myslimanët nuk kanë patur mundësinë të lexonin Shkrimet (shumë nuk kanë lexuar librin e tyre, Kuranin). Mëso të përdorësh shëmbëlltyrat, historitë, shembujt nga Bibla dhe jetën e përditshme për të ndarë mesazhin. Në këtë mënyrë shoku juaj Mysliman do të kujtonte më mirë fjalët tuaja. Për ide shiko në këtë faqe: www.oralbible.com

3. Përdor veglat e medias: Mbaj lloj të ndryshme të Ungjijve, dhe filmin "Jezusi" në kasetë, CD-ë dhe DVD-ë në gjuhë të ndryshme..

4. Kërkoj ata: Mos ki turp t'i vizitosh ata në shtëpitë e tyre dhe t'i ftosh në shtëpinë tënde. Do të ishte e urtë

që si fillim t'i ftojë për një ëmbëlsirë për të shmangur problemin lidhur me mishin.

5. Argument: Ti ke pak mundësi të bindësh një Mysliman përmes një argumenti të arsyeshem. Llogjika perëndimore nuk mbarë të njëjtën peshë për Myslimanët. Duajti miqtë e tu Myslimanë dhe shmang hyrjen në diskutim, nga ku do të shtynte ata në mbrojtjen e Islamit.

6. Kur'ani: Ti mund ta lexosh, por jo detyrimisht ta përdorësh këtë si bazën unike për të shpallur. Myslimanët kanë nevojë të takohen me Jezusin i cili zbulohet në Bibël. Nëse lexon Kuranin ose viziton një xhami është e këshillueshme të lutesh për kuptim dhe mbrojtje (Ef. 6:10-18).

7. Burrat ju shpallin burrave dhe gratë, grave: Të shpallurit gjinisë së kundërt është e pa këshillueshme, edhe përmes korespondencës. Gratë besimtare duhet të shmangin bisedat me burrat.

8. Përgatiti ata për vizitën e tyre të parë në kishë: Përgatiti miqtë Myslimanë për vizitën e tyre të parë në një kishë të Krishterë ose në një takim. Shpjegoju shkurtimisht çfarë ndodh çfarë duhet të bëjnë ose të mos bëjnë.

9. Kundërshtimi ndaj Krishtërit: Kur flet me Myslimanë ata ndoshta do të ngrënë kundërshtime që besimi ynë në Mesia është i pa pranueshem për ta. Besimtarët duhet t'i dinë këto kundërshtime dhe të përgatiten për tu marrë me korrektesi. Ka faqe interneti për këtë qëllim.

SHQIPËRIA

Të Rinjtë Me Një Mision
K.P. 119, AEP Box 33
Tiranë



TË RINJTË ME NJË MISION

Email: nationaloffice@ywam.org.al

© Copyright 2011

30 Days International
BP 80049 St. Paul-Trois-Châteaux
26131 Pierrelatte Cedex, France
30days@free.fr

Vlerat tona: “30 Ditët Ndërkombëtare” si një lëvizje mban një qëndrim pozitiv ndaj Myslimanëve. Përpjekjet tona për lutje nuk interesohen për denigrimin ose kritikën ndaj Myslimanëve ose besimeve dhe praktikave të tyre. Islami nuk është thjesht një fe ose filozofi. Islami ka të bëjë me njerëzit. Jezusi tha, “Duaje të afërmin tënd porsi vetveten.” Kjo broshurë lutjeje nuk është programuar që të përdoret si literaturë për ungjillizim. Ajo është prodhuar për t’i informuar besimtarët dhe për ta nxitur lutjen.

Faqe interneti të rekomanduara: “30 Ditët Ndërkombëtare” nuk i nënshkruan ose nuk bie dakord me të gjitha argumentat, idetë ose qëndrimet e prezantuara nga faqet e internetit të listuara në këtë fletë. Këto faqe interneti përmbajnë të paktën ca material të vlefshëm. Ato po ashtu mund të kenë ca materiale me përmbajtje negative dhe jo të dobishme. Ka mundësi që ato të mos jenë faqet më të mira të internetit në dispozicion, por redaktorët thjesht janë të familjarizuar me to.

Faqe interneti Kristiane për Islamin:

www.answering-islam.org
www.quranandinjil.org
www.engagingislam.org
www.carlmedearis.com

Faqe interneti Myslimane:

Wikipedia: Islam Portail
www.quran.com
www.answering-christianity.com
www.islam-christianity.com
www.islamicity.com
www.al-islam.org
www.muxlim.com
www.topmuslimsites.com
www.salat-time.com
www.talkislamic.com
www.understanding-islam.com

Diskutim Mysliman – Kristian:

Kërkoni ‘Christian Muslim Dialogue in Dubai’ në YouTube.com)
<http://cmcu.georgetown.edu>
(Qendra Prince Alwaleed)
www.peace-catalyst.net
www.acommonword.com
www.grace-truth.info

Dëshmi:

www.morethandreams.tv
www.muslimjourneytohope.com

Mesia për Myslimanët:

www.isaalmasih.net
www.kalimatullah.com
www.the-good-way.com
www.fatherzakaria.net
www.injil.org

Grupe/Misione

www.joshuaproject.net
www.missionfrontiers.org
www.lausanne.org

Faqe të tjera interneti:

www.iraqprayer.org
(Lutje për Irakun)
www.cryoutnow.org
www.pray-ap.info
(Lutje për Lindjen e Mesme)
www.memritv.org
(Lutje për Lindjen e Mesme)
www.barnabasfund.org
(Besimtarët e persekutuar)
‘Prayershorts channel’ në YouTube
(video lutje të shumta)

Adresa e 30 Ditët në internet: <http://www.30-days.net>

Ju lutem vini re: Shumë burime të reja janë në dispozicion në faqen e internetit “30 Ditët”.